

Ju lutemi, merrni në konsideratë faktin se ky dokument është një përkthim jo zyrtar i ofruar nga Qendra Për Nisma Ligjore Qytetare, me qëllim informimin.

Dokumenti original është i vlefshëm në gjuhën angleze në Faqen Zyrtare të Komisionit të Venecias: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)018-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)018-e)

Strasburg, 14 Tetor 2019  
**Opinioni Nr. 961 / 2019**

**CDL-AD(2019)018**

**KOMISIONI EVROPIAN PËR DEMOKRACI NËPËRMJET  
LIGJIT  
(KOMISIONI I VENECIAS)**

**ARMENIA**

**OPINION**

**MBI IMPLIKIMET KUSHTETUESE TË RATIFIKIMIT TË KONVENTËS SË  
KËSHILLIT TË EVROPËS MBI PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E DHUNËS  
NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE (KONVENTA E STAMBOLLIT)**

**Adoptuar nga Komisioni i Venecias në  
Seancën Plenare nr. 120 (Venecia, 11-12 Tetor  
2019**

**Mbi bazën e komenteve të**

**Znj. Aurela ANASTAS (Anëtare, Shqipëria)  
Znj. Veronika BÍLKOVÁ (Anëtare, Republika Çeke)  
Z. Philip DIMITROV (Anëtar, Bullgaria)  
Znj. Regina KIENER (Anëtare, Zvicra)  
Z. Martin KUIJER (Zv/Anëtare, Holanda)**

## **Përmbajtja e Lëndës**

I. Hyrje .....	3
II. Qëllimi i opinionit .....	3
III. Konventa e Stambollit.....	5
IV. Detyrime ndërkombëtare.....	10
V. Vlerësimi.....	12
VI. Konkluzione .....	23

## I. Hyrje

1. Më 25 korrik 2019, Z. Rustam Badasyan, Ministri i Drejtësisë së Armenisë, kërkoi një mendim të Komisionit të Venecias për implikimet kushtetuese të ratifikimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit ) për Armeninë.

2. Armenia nënshkroi Konventën e Stambollit më 18 Janar 2018 dhe procesi i ratifikimit ka ngelur ende pezull.

3. Për opinionin në fjalë, Znj. Aurela Anastas, Znj. Veronika Bílková, Z. Philip Dimitrov, Znj. Regina Kiener dhe Z. Martin Kuijer u emëruan si relatorë. Ky opinion u përgatit në bazë të kontributeve të tyre.

4. Opinioni u ekzaminua nga mbledhja e përbashkët e Nën-Komisioneve për të Drejtat Themelore, Pakicat Kombëtare dhe Barazisë Gjinore më 10 tetor 2019 dhe u miratua më pas në Sesionin e 120-të Plenar të Komisionit të Venecias (Venecia, 11-12 Tetor 2019).

## II. Qëllimi i opinionit

5. Komisioni i Venecias dëshiron ta fillojë këtë mendim duke përsëritur disa pika të rëndësishme: Para së gjithash, zgjedhja për të ratifikuar një traktat dhe për t'u ngarkuar me detyrimet e tij<sup>1</sup> është një akt sovran i Shtetit. Shtetet nuk kanë detyrimin të ratifikojnë traktate që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare, megjithëse ato, të cilat e kanë nënshkruar një traktat, janë të detyruara "të heqin dorë nga veprimet që bien në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e një traktati"<sup>2</sup>. Vendimi për të ratifikuar një traktat pasqyron vlerësimin juridik të instrumentit, por edhe interesa të tjera politike, ideologjike, ekonomike, sociale, kulturore, etj.

6. Së dyti, zgjidhjet kombëtare në lidhje me llojin e marrëdhënieve ndërmjet urdhrave juridikë ndërkombëtarë dhe lokalë, janë shumë të larmishme. Komisioni i Venecias e ka analizuar këtë pyetje në detaj në punën e tij të mëparshme, veçanërisht në Raportin për zbatimin e Traktateve për të Drejtat e Njeriut<sup>3</sup> dhe në Opinionin e Përkohshëm për ndryshimet në Ligjin Kushtetues Federativ për Gjykatën Kushtetuese të Federatës Ruse<sup>4</sup>. Zgjedhja e marrëdhënies së sipërpërmendur është gjithashtu një akt sovran i Shtetit<sup>5</sup>. Së fundmi, pasi një shtet nënshkruan një instrument të së drejtës ndërkombëtare, i kërkohet - në bazë të nenit 26 të Konventës së Vjenës për të Drejtën mbi Traktatet (Pacta sunt servanda) - të respektojë detyrimet e traktatit "në mirëbesim". Neni 27 i Konventës së Vjenës ("E drejta e brendshme dhe respektimi i traktateve") përcakton më tej se "a) një palë nuk mund të referojë në dispozitat e ligjit të saj të brendshëm, për të justifikuar dështimin e saj në zbatimin e një traktati". Kjo do të thotë që, pas ratifikimit dhe hyrjes në fuqi së tij, asnjë argument ligjor i bazuar në të drejtën kombëtare, përfshirë edhe të drejtën kushtetuese, nuk mund të justifikojë një akt ose shfuqizim në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare<sup>6</sup>. Efektet e kësaj të fundit brenda rendit juridik të brendshëm të shtetit përfaqësojnë një pjesë

<sup>1</sup> Shih Nenin 12 dhe 14 të Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve (1969)

<sup>2</sup> Neni 18 i Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve (1969)

<sup>3</sup> Shih Komisioni i Venecias, Raporti mbi zbatimin e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në të drejtën e brendshme dhe roli i gjykatave (CDL-AD (2014) 036); Komisioni i Venecias, Statusi i traktateve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut (CDL-STD (2005) 042).

<sup>4</sup> CDL-AD(2016)005, Appendix i CDL-AD(2016)016, paragrafet 81 et seq.

<sup>5</sup> Shih André Nollkaemper, *National Courts and the International Rule of Law*, Oxford University Press, 2012, p. 68-70. Hulumtimi ka treguar se karakteri i sistemit kushtetues për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare përmes praktikës gjyqësore është shumë më pak i rëndësishëm në shpjegimin e ndikimit të së drejtës ndërkombëtare nga sa shpesh supozohet: J. Gerards & J. Fleuren (eds.), *Implementation of the European Convention on Human Rights and of the Judgments of the GJEDNJ in national case-law*, Intersentia 2014, fq. 371.

<sup>6</sup> Trajtimi i shtetasve polakë, PCIJ Rep. 1932, Ser A/B, No. 44, p. 4.

thelbësore të respektimit (me mirëbesim) të dispozitave ligjore ndërkombëtare.

7. Për sa i përket procesit të ratifikimit të traktateve ndërkombëtare, Kushtetuta e Armenisë përcakton që “traktatet ndërkombëtare që kundërshtojnë Kushtetutën nuk mund të ratifikohen” (neni 116(3)). Në bazë të nenit 168 (3) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Armenisë është kompetente që “përpara ratifikimit të një traktati ndërkombëtar, të përcaktojë përputhshmërinë me Kushtetutën të detyrimeve të përcaktuara në të”. Në bazë të nenit 72 (1) të Ligjit Organik të Gjykatës Kushtetuese të Armenisë<sup>7</sup>, Qeveria e Armenisë i kërkon Gjykatës Kushtetuese të verifikojë përputhshmërinë me Kushtetutën të çdo traktati ndërkombëtar që është objekt ratifikimi nga Kuvendi, përpara ratifikimit të tij.

8. Vlerësimi i pajtueshmërisë së një traktati me Kushtetutën e Armenisë është një çështje e Gjykatës Kushtetuese të Armenisë. Pikëpamjet e shprehura nga organe ekspertësh ndërkombëtarë, siç është Komisioni i Venecias, mund ta ndihmojnë këtë Gjykatë në detyrën e saj, duke siguruar një analizë të jashtme juridike të traktatit ndërkombëtar në fjalë, por Komisioni i Venecias nuk mund të vlerësojë përfundimisht implikimet kushtetuese të Konventës, për aq kohë sa është jo kompetent për të interpretuar në mënyrë autoritative Kushtetutën armene. Sidoqoftë, këto pikëpamje shërbejnë për të dhënë një kontribut në debatin publik mbi ratifikimin e një traktati.

9. Në kërkesën e tij për këtë opinion, Ministri i Drejtësisë së Armenisë i ka kërkuar Komisionit të Venecias të vlerësojë implikimet kushtetuese të ratifikimit të Konventës së Stambollit, pa identifikuar ndonjë implikim specifik mbi të cilin do të dëshironte të përqendrohej Komisioni. Ky i fundit ka vlerësuar implikimet kushtetuese të ratifikimit të një traktati specifik në të kaluarën. Për shembull, në 1998, ai miratoi një opinion mbi çështjet kushtetuese të përfshira në pranimin e Estonisë në Bashkimin Evropian<sup>8</sup>. Në vitet 2000 dhe 2008, ai vlerësoi çështjet kushtetuese të ngritura nga ratifikimi i Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare<sup>9</sup>. Gjithashtu në vitin 2001, Komisioni hartoi një opinion mbi ratifikimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me kërkesë të Armenisë<sup>10</sup>. Ky opinion përmban një pjesë të përgjithshme për marrëdhëniet midis Kushtetutës së Armenisë dhe traktateve ndërkombëtare. Megjithëse kuadri ligjor është pjesërisht i ndryshuar pas ndryshimeve kushtetuese të bëra në 2005 dhe 2015, parimi kryesor - domethënë, nëse konstatohen kontradikta midis Kushtetutës dhe një traktati, “do të kërkohet një ndryshim kushtetues përpara ratifikimit në fjalë.” (Paragrafi 3) - mbetet i zbatueshëm. E njëjta gjë vlen për përkufizimin e termit “kontradiktë” si “një papajtueshmëri e rreptë midis dy dispozitave, d.m.th. dispozita të përfshira në Kushtetutë dhe në traktat” (paragrafi 4).

10. Prandaj, sipas këtij opinion dhe në përputhje me praktikën e tij të mëparshme, Komisioni i Venecias do të merret me çështjet që janë bërë objekt debati publik (ligjor) në lidhje me ratifikimin e kësaj Konvente në Armeni apo në ndonjë vend tjetër, për të cilat Komisioni është në dijeni. Gjithashtu, në vlerësimin e implikimeve kushtetuese të ratifikimit të mundshëm të Konventës së Stambollit nga Armenia, Komisioni i Venecias u mbështet në tekstin dhe Raportin Shpjegues të Konventës së Stambollit. Analiza kufizohet në gjendjen aktuale të ligjit dhe nuk spekulon në lidhje me interpretimin e mundshëm në të ardhmen dhe zbatimin e Konventës.

<sup>7</sup> “1. Përpara ratifikimit të një marrëveshje ndërkombëtare nga Asambleja Kombëtare, Presidenti i Armenisë do të apelojë në Gjykatën Kushtetuese, në lidhje me përputhshmërinë me Kushtetutën të detyrimeve të marra brenda marrëveshjes.” [http://www.concourt.am/english/law\\_cc/index.htm](http://www.concourt.am/english/law_cc/index.htm)

<sup>8</sup> *Opinion mbi çështjet kushtetuese të përfshira në pranimin e Estonisë në Bashkimin Evropian* (CDL-INF(98)10).

<sup>9</sup> *Raport për çështje kushtetuese të ngritura nga ratifikimi i statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare* (CDL(2000)104); *Raporti i Dytë për çështjet kushtetuese të ngritura nga Ratifikimi i Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare - Shtojcë e Raportit për çështje kushtetuese të ngritura nga ratifikimi i Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare* (CDL-AD(2008)031).

<sup>10</sup> *Opinion mbi ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore sipas Kushtetutës së Republikës së Armenisë së 1995* (CDL-INF(2001)25).

11. Çështjet kryesore që janë ngritur në këtë kontekst janë: a) që Konventa e Stambollit nuk është e nevojshme; b) që Konventa e Stambollit përmban terma dhe koncepte të caktuara që bien ndesh me termat dhe konceptet e përcaktuara në kushtetutën kombëtare të vendit në shqyrtim; c) që Konventa e Stambollit do të rezultojë në ndryshime legislative, të cilat do të kundërshtojnë kushtetutën kombëtare të vendit në shqyrtim; d) që Konventa e Stambollit prezanton një organ me kompetenca të tepërta; dhe së fundi, e) që Konventa e Stambollit prezanton angazhime të reja në fushën e ligjit për azilin.

### III. Konventa e Stambollit

#### A. Komente të përgjithshme

12. Konventa e Këshillit të Evropës mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur ndryshe si Konventa e Stambollit, është miratuar në 11 Maj 2011 në Stamboll të Turqisë. Konventa synon të “mbrojë gratë nga të gjitha format e dhunës, si dhe të parandalojë dhe eliminojë dhunën kundër grave dhe dhunën në familje” (Neni 1(1)(a)). Ajo “zbatohet për të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë jo proporcionale” (Neni 2).

13. Konventa e Stambollit hyri në fuqi më 1 gusht 2014, pas ratifikimit nga 10 shtete. Deri në gusht të vitit 2019, ajo ishte ratifikuar nga 34 shtete anëtare të Këshillit të Evropës dhe ishte nënshkruar nga të gjitha shtetet e tjera anëtare, me përjashtim të Azerbajxhanit dhe Federatës Ruse. Ajo është nënshkruar gjithashtu nga një organizatë ndërkombëtare, Bashkimi Evropian. Rezerva për këtë Konventë u bënë nga 22 shtete palë në zbatim të nenit 78. Pesë Shtete Palë miratuan deklaratat, njëra prej të cilave, Polonia, ishte kundërshtuar nga gjashtë shtete.<sup>11</sup>

14. Në dy vende, Bullgari dhe Sllovakia, procesi i ratifikimit u ndërpre kohët e fundit. Në Bullgari, pezullimi rezultoi nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese që gjeti një kontradiktë midis Konventës së Stambollit dhe Kushtetutës së Bullgarisë<sup>12</sup>, e cila u referua edhe në Armeni si një argument kundër ratifikimit të kësaj Konvente. Në Sllovakia, më 29 Mars 2019, Këshilli Kombëtar votoi me shumicë të madhe kundër ratifikimit të Konventës së Stambollit duke kërkuar nga qeveria të ndërpresë procesin e ratifikimit.<sup>13</sup>

15. Armenia nënshkroi Konventën e Stambollit më 18 Janar 2018. Ndërsa nënshkroi, Armenia miratoi një rezervë, mbi të drejtën për të mos zbatuar dispozitat e Konventës të përcaktuara në nenin 30 (2) - kompensimi, nenin 55(1) – procedurat ex parte dhe ex officio, në funksion të nenit 35 në lidhje me kundërvajtjet, nenin 58 - statuti i kufizimit, në funksion të nenit 37 dhe nenin 59 - statusi i vendbanimit.

#### B. Fusha e zbatimit

16. Qëllimi i Konventës së Stambollit, siç përcaktohet në Preambulën e saj, është të “krijojë një Evropë pa dhunë ndaj grave dhe dhunë në familje”. Prandaj, Shtetet Anëtare janë të detyruara të krijojnë një kuadër ligjor kombëtar për të luftuar, parandaluar dhe ndjekur penalisht të gjitha format e dhunës ndaj grave<sup>14</sup>. Për më tepër, Konventa thekson ndërlidhjen midis fuqizimit të grave, si p.sh. barazisë gjinore, dhe eliminimit të të gjitha formave të dhunës kundër tyre.<sup>15</sup>

<sup>11</sup> Deklarata përcakton: “Republika e Polonisë deklaron se do të zbatojë Konventën në përputhje me parimet dhe dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Polonisë.” Letonia dhe Lituania kanë miratuar deklaratat shumë të ngjashme (“në përputhje” zëvendësohet me “konform”), të cilat nuk janë kundërshtuar nga asnjë Shtet Palë.

<sup>12</sup> Gjykata Kushtetuese Bullgare, *Решение № 13*, 27 юли 2018 г.

<sup>13</sup> Sllovakia, Këshilli Kombëtar, *Uznesenie Národnej rady Slovenskej republiky k procesu ratifikácie Dohovoru Rady Európy o predchádzaní násilliu na ženách a domácemu násilliu a o boji proti nemu Slovenskou republikou (tlač 1409)*, 29 March 2019.

<sup>14</sup> Neni 1(1)(c), 12(2) i Konventës së Stambollit.

<sup>15</sup> Preambula, Neni 1(b), neni 12 i Konventës së Stambollit; Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për

17. Për të arritur këtë qëllim, Konventa e Stambollit bazohet në instrumente të tjerë ndërkombëtarë, siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tej KEDNJ) si dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më tej GJEDNJ). Për më tepër, ajo i referohet dhe përbën një përmirësim për standardet e përcaktuara në Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (më tej CEDAW)<sup>16</sup>. Në përfundim, Konventa e Stambollit pasqyron parimet e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (më tej ICCPR), Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (më tej ICESCR) dhe Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (më tej UNCAT).

18. Konventa e Stambollit bazohet në këto instrumente, por është përqendruar në mënyrë specifike në dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, të cilat nuk adresohen në mënyrë të qartë nga instrumentet më të vjetra, pavarësisht faktit se ato janë identifikuar vazhdimisht si një shkelje serioze dhe e zakonshme e të drejtave të njeriut<sup>17</sup>. Ajo ndjek shembullin e Konventës Ndër-Amerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Zhdukjen e Dhunës ndaj Grave (Convention of Belém do Pará 1994)<sup>18</sup>, e miratuar nën kujdesin e Organizatës së Shteteve Amerikane (më tej OAS) në 1994, si dhe Protokollit të Kartës Afrikane mbi të drejtat e njeriut dhe mbi të drejtat e grave në Afrikë të miratuar në vitin 2003, i njohur më mirë si “Protokolli Maputo”<sup>19</sup>.

19. Shtetet që kanë ratifikuar Konventën e Stambollit janë të detyruar jo vetëm të ndëshkojnë veprat penale në lidhje me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje përmes sanksioneve legislative (nenet 29-48 të Konventës së Stambollit), por ata gjithashtu duhet të sigurojnë një grup masash gjithëpërfshirëse për të mbrojtur të gjithë viktimat (e mundshme) nga çdo veprim i dhunshëm (i ardhshëm) (nenet 18-28 të Konventës së Stambollit). Për më tepër, Shtetet Anëtare janë të detyruara të ndërgjegjësojnë dhe informojnë publikun për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe forcimin e barazisë midis burrave dhe grave (Nenet 12-17 të Konventës së Stambollit).

20. Siç u përmend më lart, Konventa e Stambollit lufton të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Neni 3 (a) dhe (b) i kësaj Konvente<sup>20</sup> parashikon një përkufizim të “dhunës ndaj grave, si dhe dhunës në familje”, me qëllim promovimin e një kuptimi më të mirë të të dy termave dhe t'i dallojë ato nga njëra-tjetra.

21. Përkufizimi i “dhunës ndaj grave” në nenin 3 (a) të Konventës së Stambollit i referohet të gjitha akteve të dhunës me bazë gjinore, siç janë dëmtimi fizik, seksual ose

---

parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (më tej, "Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit"), paragrafët 25, 31.

<sup>16</sup> Preambula e Konventës së Stambollit; Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafët 40, 44, 50, 52; Grans, Konventa e Stambollit dhe Detyrimi Pozitiv për Parandalimin e Dhunës, 18 Rishikimi i Ligjit për të Drejtat e Njeriut (2018), 136.

<sup>17</sup> Në nivel OKB-je, shih UN Doc. A/47/38, *CEDAW General Recommendation No. 19, Violence Against Women*, 1992; UN Doc. A/RES/48/104, *Declaration on the Elimination of Violence against Women*, 23 February 1994; UN Doc. A/61/122/Add.1, *In-depth study on all forms of violence against women, Report of the Secretary-General*, 7 July 2006; UN Doc. CEDAW/C/CG/35, *General recommendation No. 35 on gender-based violence against women, updating general recommendation No. 19*, 14 July 2017; etc. Pë Këshillin e Evropës, shih *Recommendation No. R (2002) 5 of the Committee of Ministers to member States on the protection of women against violence*, 30 April 2002.

<sup>18</sup> <https://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-61.html>

<sup>19</sup> [https://www.un.org/en/africa/osaa/pdf/au/protocol\\_rights\\_women\\_africa\\_2003.pdf](https://www.un.org/en/africa/osaa/pdf/au/protocol_rights_women_africa_2003.pdf)

<sup>20</sup> “Neni 3 – Përkufizime

*Për qëllim të kësaj Konvente:*

*a - "dhuna ndaj grave" kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimit ndaj grave, duke nënkuptuar të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që ndodhin, ose ka të ngjarë të ndodhin, fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike apo vuajtje për gratë, përfshirë kërcënimet për veprime të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike ose private;*

*b - "dhuna në familje" nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, midis bashkëshortëve apo partnerëve të mëparshëm ose aktualë, pavarësisht nëse autori ndan ose jo të njëjtin vendbanim me viktimën;”*

psikologjik, si dhe detyrimi ose privimi arbitrar i lirisë. Termi thekson që çdo formë e dhunës ndaj grave përbën një shkelje të të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi.<sup>21</sup>

22. Natyra gjinore e dhunës ndaj grave, siç përcaktohet në Konventën e Stambollit, rezulton nga fakti se shumë forma të dhunës janë të drejtuara ndaj grave sepse ato janë gra, ose sepse këto akte prekin gratë në mënyrë jo proporcionale<sup>22</sup>. “Duke njohur natyrën strukturore të dhunës ndaj grave si dhunë me bazë gjinore”<sup>23</sup>, Konventa e Stambollit po miraton standardin e përcaktuar nga Komiteti CEDAW, i cili pranon se “dhuna me bazë gjinore ndaj grave përbën diskriminim ndaj tyre sipas nenit 1 (CEDAW) (...)”<sup>24</sup>. “Me fjalë të tjera: gjinia e viktimës, d.m.th të qenurit femër, është motivi kryesor për kryerjen e akteve të dhunës të përshkruara në Konventën e Stambollit dhe për këtë arsye përbën diskriminim ndaj grave.”<sup>25</sup>

23. Duke përcaktuar termin gjini në nenin 3(c)<sup>26</sup>, Konventa e Stambollit pranon se dhuna ndaj grave nuk buron vetëm nga dallimet biologjike midis burrave dhe grave, pra seksi, por kryesisht nga “role, sjellje dhe attribute të ndërtuara që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat”<sup>27</sup>. Stereotipa të tilla të gjinisë kontribuojnë në statusin vartës të grave në shoqëri dhe mund të bëjnë të pranueshme praktikatat e dëmshme dhe dhunën ndaj grave në sferën private dhe publike.<sup>28</sup>

24. Ndalimi i diskriminimit të grave në bazë të gjinisë është njohur nga shumë traktate të të drejtave të njeriut. Si rezultat, termi gjini, si dhe dëmi i krijuar nga stereotipat gjinore është adresuar nga një sërë organesh të traktateve të KB, si dhe nga GJEDNJ<sup>29</sup>. Sipas Komitetit CEDAW, termi gjini i referohet “identiteteve të ndërtuara shoqërore, attributeve dhe roleve për gratë dhe burrat, si dhe kuptimi shoqëror e kulturor i shoqërisë për këto ndryshime biologjike që rezultojnë në marrëdhënie hierarkike midis grave dhe burrave; dhe në shpërndarjen e fuqisë dhe të drejtave që favorizojnë burrat dhe dëmtojnë gratë.”<sup>30</sup>

25. Për të luftuar stereotipet e dëmshme gjinore, neni 5 i CEDAW dhe - në një masë më të vogël - neni 2(f) krijojnë detyrime të qarta që shtetet palë të marrin masa të përshtatshme për të eliminuar modelet e tilla sociale dhe kulturore<sup>31</sup>. Në mënyrë të ngjashme, Komiteti i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (më tej CESCR) ka theksuar se gjinia gjithashtu “ndikon në të drejtën e barabartë të burrave dhe grave për të gëzuar të drejtat e tyre”<sup>32</sup>. Sipas formulimit të CESCR, nocioni i gjinisë përfshin “pritshmëritë dhe supozimet kulturore në lidhje me sjelljen, qëndrimet, tiparet e personalitetit dhe aftësitë fizike e intelektuale të burrave dhe grave, bazuar vetëm në identitetin e tyre si burra ose gra.”<sup>33</sup> Një qasje e ngjashme gjendet në Komentin e Përgjithshëm mbi Barazinë midis Burrave dhe Grave të Komitetit për të Drejtat e Njeriut,

<sup>21</sup> Neni 3(a) i Konventës së Stambollit: “dhuna ndaj grave” *kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimit ndaj grave, duke nënkuptuar të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që ndodhin, ose ka të ngjarë të ndodhin, fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike apo vuajtje për gratë, përfshirë kërcënimet për veprime të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike ose private.*

<sup>22</sup> Neni 3 (d) i Konventës së Stambollit; Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafi 44.

<sup>23</sup> Preambula e Konventës së Stambollit.

<sup>24</sup> Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 35: Dhuna me bazë gjinore ndaj grave që përditëson rekomandimin 19, 26 korrik 2017, paragrafi 21; Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 19: Dhuna ndaj grave (1992), paragrafët 1, 6.

<sup>25</sup> Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafi 44.

<sup>26</sup> “c - “Gjini” do të thotë rolet, sjelljet, aktivitetet dhe attribute të ndërtuara shoqërore, të cilat një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat.”

<sup>27</sup> Neni 3 (c) i Konventës së Stambollit; Konventa e Stambollit, Pyetjet dhe Përgjigjet (më tej: Këshilli i Evropës, Q&A), 6.

<sup>28</sup> Idem.

<sup>29</sup> Agjensia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe Këshilli i Evropës, Manual për ligjin evropian kundër diskriminimit (2018), 170 – 171.

<sup>30</sup> Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 28: Detyrimet thelbësore të Shteteve Palë sipas Nenit 2 CEDAW, 16 Dhjetor 2010, paragrafi 5.

<sup>31</sup> Raporti i Komisionuar i OHCHR (2013), Stereotipet Gjinore si Shkelje e të Drejtave të Njeriut, 21 – 22.

<sup>32</sup> CESCR, Komenti i Përgjithshëm 16: Neni 3 (Barazia e të Drejtave midis Burrave dhe Grave për të gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore), 11 Gusht 2005, paragrafi 14.

<sup>33</sup> Idem.

në të cilin theksohet se “pabarazia në gëzimin e të drejtave nga gratë në të gjithë botën është ngulitur thellësisht në traditë, histori dhe kulturë, përfshirë edhe qëndrimet fetare”<sup>34</sup>.

26. GJEDNJ ka vlerësuar se një ndryshim në trajtimin midis burrave dhe grave nuk mund të justifikohet duke iu referuar shpërndarjes tradicionale të roleve gjinore në shoqëri.<sup>35</sup>

27. Përveç përkufizimit të termit dhunë ndaj grave, neni 3(b) i Konventës së Stambollit parashikon gjithashtu një përkufizim të nocionit të dhunës në familje. Kështu, dhuna në familje i referohet “të gjitha veprimeve të dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes apo shtëpisë ose midis bashkëshortëve apo partnerëve të mëparshëm ose aktualë”<sup>36</sup>. Përkufizimi i dhunës në familje përfshin edhe burrat, fëmijët dhe të moshuarit si viktimat të mundshme<sup>37</sup>. Sidoqoftë, përgjithësisht pranohet se shumica e viktimave të prekura nga dhuna në familje janë gra<sup>38</sup>. Prandaj, dhuna në familje përbën një formë tjetër dhune, e cila është e veçuar nga ajo gjinore.<sup>39</sup>

28. Konventa e Stambollit lufton dhunën në familje pa marrë parasysh situatën familjare në të cilën ndodh. Dhuna në familje mund të rezultojë në dhunë midis bashkëshortëve aktualë, ish-bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues, si dhe në dhunën midis dy ose më shumë anëtarëve të gjeneratave të ndryshme të familjes<sup>40</sup>. Meqenëse qëllimi i saj është të adresojë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje kudo ku ndodh, Konventa e Stambollit nuk e kufizon aplikimin e saj tek bashkëshortët, por e shtrin atë tek të gjithë partnerët, të martuar apo jo, pavarësisht nëse këta janë të të njëjtit seks. Asnjë grup viktimash nuk përjashtohet nga mbrojtja si pasojë e statusit të tyre martesor apo ndonjë arsyeje tjetër të diskriminimit të përfshirë në Konventë.<sup>41</sup>

### C. Shtrirja e aplikimit

29. Meqenëse qëllimi kryesor i Konventës së Stambollit është të mbrojë gratë nga të gjitha format e dhunës (neni 1(1)(a)) dhe të promovojë fuqizimin e tyre (neni 1(1)(b)), ajo zbatohet para së gjithash për gratë dhe vajzat (neni 3(f)). Për më tepër, fushëveprimi i kufizuar i aplikimit vjen nga fakti se Konventa e Stambollit kryesisht mbulon forma dhune që përjetojnë vetëm nga gratë sepse ato janë gra (siç janë aborti i detyruar ose gjymtimi i organit gjeneral të femrave) apo që prekin gratë në mënyrë jo proporcionale (siç është përdhunimi, kërcërimi, dhuna në familje ose martesa e detyruar).<sup>42</sup>

30. Sidoqoftë, siç tregohet më lart, Konventa e Stambollit pranon gjithashtu që meshkujt mund të jenë viktimat të dhunës në familje<sup>43</sup>. Ata përjetojnë disa forma të dhunës të mbuluara nga Konventa, megjithëse më rrallë dhe shpesh në forma më pak të rënda. Konventa e Stambollit e njeh këtë dhe inkurajon Shtetet Palë të zbatojnë dispozitat e saj për të gjithë viktimat e dhunës në familje, përfshirë burrat, fëmijët dhe të moshuarit.<sup>44</sup>

31. Ndalimi i diskriminimit, parashikuar në nenin 4(3) të Konventës së Stambollit<sup>45</sup>

<sup>34</sup> CCPR, Komenti i Përgjithshëm 28: Neni 3 (Barazia e të Drejtave midis Burrave dhe Grave), 29 Mars 2000, paragrafi 5.

<sup>35</sup> GJEDNJ, Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Rusisë [GC], nr. 60367/08 dhe 961/11, gjykimi i 24 janarit 2017, paragrafët 141 - 143.

<sup>36</sup> Neni 3 (b) i Konventës së Stambollit.

<sup>37</sup> Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafi 41.

<sup>38</sup> GJEDNJ, Opuz kundër Turqisë, Nr. 33401/02, gjykim i 9 qershorit 2009.

<sup>39</sup> Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafi 42.

<sup>40</sup> Idem., paragrafet 41 – 42.

<sup>41</sup> Idem.; Këshilli i Evropës, Q&A, 7.

<sup>42</sup> Shih Nenin 3 (d) të Konventës së Stambollit: Përkufizimi i "dhunës me bazë gjinore ndaj grave"; Nenet 32-40 të Konventës së Stambollit; Këshilli i Evropës, Q&A, 5.

<sup>43</sup> Këshilli i Evropës, Q&A, 5; Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafët 41, 45.

<sup>44</sup> Idem.

<sup>45</sup> “Neni 4 - Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi

3 - Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, në veçanti masat për të mbrojtur të drejtat e viktimave, do të



siguron mbrojtje të barabartë për të gjithë viktimat e dhunës (në familje), pavarësisht karakteristikave që mund të kenë. E drejta për të mos u diskriminuar është një element thelbësor mbi të cilin bazohet i gjithë sistemi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut<sup>46</sup>. Parimi i mosdiskriminimit garanton që “çdo individ ka të drejtë të gëzojë të gjitha të drejtat dhe liritë [...] pa asnjë lloj dallimi, [...]”<sup>47</sup>. Kjo dispozitë gjendet në të gjitha konventat kryesore të të drejtave të njeriut si neni 2(1), neni 26 i ICCPR, neni 2(2) i ICESCR dhe neni 14 i KEDNJ-së. Konventa e Stambollit siguron mbrojtje kundër diskriminimit bazuar në një listë kriteresh të hapura, përfshirë identitetin gjinor dhe orientimin seksual<sup>48</sup>. Duke zbatuar dispozitat e Konventës së Stambollit pa diskriminuar për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, Konventa pranon që çdokush mund të jetë viktimë e dhunës në familje. Për më tepër, Konventa e Stambollit siguron që çdo person, pavarësisht nga orientimi seksual apo identiteti i tij gjinor, është i mbrojtur nga dhuna në familje dhe ka akses në çdo mjet mbrojtjeje nga to.

32. Konventa e Stambollit nuk përcakton standarde të reja duke përfshirë dy fushat e lartpërmendura në listën e dallimeve të ndaluara, d.m.th identitetin gjinor dhe orientimin seksual. Përkundrazi, ajo “bazohet në detyrime ligjore që burojnë në instrumente të tjera ligjore”<sup>49</sup> siç është KEDNJ dhe praktika gjyqësore përkatëse, CEDAW, ICCPR, ICESCR dhe UNCAT.

33. GJEDNJ, për shembull, në interpretimin e KEDNJ-së, lejon aplikantët që pësojnë diskriminim bazuar në orientimin e tyre seksual dhe / ose identitetin gjinor të pretendojnë shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me një tjetër të drejtë thelbësore të KEDNJ<sup>50</sup>.

34. Organe të tjera të të drejtave të njeriut kanë ngritur gjithashtu çështjen e orientimit seksual dhe diskriminimit të lidhur me identitetin gjinor. Komiteti CEDAW, për shembull, ka lëshuar dy Rekomandime të Përgjithshme, në të cilat pranon se diskriminimi i pësuar nga gratë është “i lidhur në mënyrë të pandashme” me faktorë të tjerë që prekin gratë, si orientimi seksual dhe identiteti gjinor<sup>51</sup>.

35. Komiteti për të Drejtat e Njeriut, nga ana e tij, ka konstatuar se referenca ndaj seksit në nenin 2(1) dhe nenin 26 të ICCPR përfshin gjithashtu orientimin seksual<sup>52</sup>. Sipas jurisprudencës së tij, Komiteti për të Drejtat e Njeriut konsideron se Shtetet Palë duhet të sigurojnë që të gjithë individët në territorin e tyre përfitojnë nga të drejtat e përcaktuara në ICCPR, si dhe gëzojnë mbrojtje të barabartë përpara ligjit pa asnjë dallim në asnjë fushë, përfshirë orientimin seksual (neni 2(1) dhe neni 26 i ICCPR)<sup>53</sup>.

36. CESCER ka adoptuar një koment të përgjithshëm për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, në të cilin ka njohur që gëzimi i të drejtave të parashikuara në ICESCR nga një person, nuk mund të kufizohet në bazë të orientimit të tij seksual ose identitetit gjinor. CESCER në mënyrë të qartë pranoi që sipas nenit 2(2) të ICESCR, kriteri “status tjetër” përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Si pasojë,

---

*sigurohet pa diskriminim mbi asnjë bazë siç janë seksi, gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik, origjina kombëtare ose shoqërore, të qenurit pjesë e një pakice kombëtare, prona, lindja, orientimi seksual, identiteti gjinor, mosha, gjendja shëndetësore, paaftësia, statusi martesor, statusi i migrantit ose refugjatit, ose çdo status tjetër.”*

<sup>46</sup> Moeckli, Barazia dhe Mosdiskriminimi, në: Moeckli / Shah / Sivakumaran, *International Human Rights Law* (2018), 148, 152.

<sup>47</sup> Neni 1 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

<sup>48</sup> *Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafi 53.*

<sup>49</sup> Këshilli i Evropës, Q&A, 9.

<sup>50</sup> GJEDNJ, *X and Others v. Austria* [GC], No. 19010/07, gjykim i 19 shkurtit 2013; GJEDNJ, *Taddeucci and McCall v. Italy*, No. 51362/09, gjykim i 30 qershorit 2016; GJEDNJ, *Sousa Goucha v. Portugal*, No. 70434/12, gjykim i 22 marsit 2016, paragrafi 27.

<sup>51</sup> Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 27: Gratë e moshuara dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, 16 dhjetor 2010, paragrafi 13; Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 28: Detyrimet thelbësore të Shteteve Palë sipas Nenit 2 CEDAW, 16 Dhjetor 2010, paragrafi 18.

<sup>52</sup> HRC, *Toonen v. Australia*, No. 488/1992, 31 March 1994, paragrafi 8.7.

<sup>53</sup> HRC, *X v. Colombia*, No. 1361/2005, 13 janar 2001, paragraf 7.2; HRC, *Young v. Australia*, No. 941/2000, 29 qershor 1999, paragraf 10.2.

orientimi seksual ose identiteti gjinor i një personi është ndër fushat e ndaluara të diskriminimit të përcaktuara në nenin 2(2) të ICESCR<sup>54</sup>.

37. Në fund, në lidhje me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga UNCAT, Shtetet Palë duhet të sigurojnë që UNCAT të zbatohet për të gjithë personat, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual apo identiteti transgjinor<sup>55</sup>.

#### IV. Detyrimet Ndërkombëtare

38. Detyrimi për të mbrojtur çdo individ nga dhuna me bazë gjinore rezulton nga ratifikimi i traktateve të mëposhtme të të drejtave të njeriut:

1. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore – KEDNJ (TIF<sup>56</sup>: 1953);<sup>57</sup>
2. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike – ICCPR (TIF: 1976);<sup>58</sup>
3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore – ICESCR (TIF: 1976);<sup>59</sup>
4. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave – CEDAW (TIF: 1981);<sup>60</sup> dhe
5. Konventa për torturën dhe trajtimet apo ndëshkimet çnjerëzore e degraduese - UNCAT (TIF: 1987)<sup>61</sup>.

39. Së pari, dështimi për të mbrojtur një individ nga dhuna në familje, si dhe për të parandaluar dhunën ndaj grave, mund të rezultojë në shkeljen e së drejtës për jetën ose të drejtës për t'u çliruar nga torturat dhe / ose keqtrajtimet e tjera të përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të KEDNJ-së, si dhe në nenet 6 dhe 7 të ICCPR<sup>62</sup>.

40. Në lidhje me nenet 2 dhe 3 të KEDNJ, GJEDNJ ka vendosur që Shtetet Anëtare kanë një detyrim pozitiv për të mbrojtur individët nga privimi i jetës, si dhe nga keqtrajtimi, nëse këto akte janë kryer nga një person privat<sup>63</sup>. Për më tepër, Shtetet Anëtare janë të detyruara të marrin masa adekuate për të kriminalizuar aktet e dhunës dhe ngacmimin. Me fjalë të tjera, në rastet e dhunës në familje, shtetet anëtare duhet të marrin të gjitha masat (legjislative) për të mbrojtur individët e prekur<sup>64</sup>. Edhe pse dhuna në familje nuk ka degraduar ende në dhunë fizike, por vetëm në kërcënime të përsëritura ndaj një individi, mund të kemi shkelje të së drejtës për integritetin fizik dhe psikologjik, e parashikuar në nenin 8 të KEDNJ<sup>65</sup>. Si rezultat, shtetet anëtare kanë detyrimin për të mbrojtur individët nga ndërhyrjet e tilla nga palët e treta<sup>66</sup>. Në fund, GJEDNJ ka pranuar se në vendet anëtare ku viktimat e prekura nga dhuna në familje janë kryesisht gra, dhuna në familje mund të konsiderohet si dhunë me bazë gjinore dhe për këtë arsye mund të përbëjë shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së, në lidhje me nenet 2 dhe 3 të KEDNJ-së.<sup>67</sup>

41. Në mënyrë që të mos shkelin nenet 6 dhe 7 të ICCPR, Shtetet Palë duhet të

<sup>54</sup> CESCR, Komenti i Përgjithshëm 20: Neni 2 (2) (Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore), 2 korrik 2009, paragrafi 32.

<sup>55</sup> CAT, Komenti i Përgjithshëm 2: Zbatimi i Nenit 2 nga Shtetet Palë, 24 Janar 2008, paragrafi 21.

<sup>56</sup> TIF = Traktat në fuqi.

<sup>57</sup> Viti i ratifikimit nga Armenia: 2002.

<sup>58</sup> Viti i ratifikimit nga Armenia: 1993.

<sup>59</sup> Viti i ratifikimit nga Armenia: 1993.

<sup>60</sup> Viti i ratifikimit nga Armenia: 1993.

<sup>61</sup> Viti i ratifikimit nga Armenia: 1993.

<sup>62</sup> Joseph / Dipnall, Fusha e Aplikimit, në: Moeckli / Shah / Sivakumaran, Ligji Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut (2018), 115; GJEDNJ, Opuz kundër Turqisë, Nr. 33401/02, gjykimi i 9 qershorit 2009; CCPR, Komenti i Përgjithshëm 28: Neni 3 (Barazia e të Drejtave midis Burrave dhe Grave), 29 Mars 2000, paragrafët 10, 11.

<sup>63</sup> GJEDNJ, Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 23452/94, gjykimi i 28 tetorit 1998, paragrafi 115; GJEDNJ, Rasti i Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 29392/95, gjykimi i 10 maj 2001, paragrafi 73.

<sup>64</sup> Grabenwarter, European Convention on Human Rights: Commentary (2014), Neni 3 ECHR, paragrafi 18.

<sup>65</sup> Grabenwarter, European Convention on Human Rights: Commentary (2014), Neni 8 ECHR, paragrafi 74.

<sup>66</sup> GJEDNJ, A kundër Kroacisë, nr 55164/08, gjykimi i 14 tetorit 2010, paragrafi 57..

<sup>67</sup> GJEDNJ, Opuz kundër Turqisë, Nr. 33401/02, gjykimi i 9 qershorit 2009, paragrafi 198.

mbrojnë gratë nga praktikat që shkelin të drejtën e tyre të jetës dhe / ose që i ekspozojnë ato ndaj një trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtëruës<sup>68</sup>. Prandaj shtetet duhet procedojnë dhe ndëshkojnë llojet e ndryshme të dhunës ndaj grave. Për më tepër, Komiteti për të Drejtat e Njeriut thekson se thjesht miratimi i masave për të mbrojtur gratë nuk është i mjaftueshëm për t'u pajtuar me ICCPR. Detyrimi i ICCPR shtrihet në vendosjen e masave për të arritur një fuqizim efektiv dhe të barabartë të grave.<sup>69</sup>

42. Siç shihet më lart (shih III.B), Komiteti CEDAW e ka interpretuar dhunën me bazë gjinore si një formë diskriminimi ndaj grave, e cila është e ndaluar në bazë të nenit 1 të CEDAW<sup>70</sup>. Rrjedhimisht, dhuna “e drejtuar ndaj gruas sepse ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë jo proporcionale” shkel jo vetëm të drejtën e tyre për jetën dhe të drejtën e tyre për të mos iu nënshtruar një trajtimi mizor, çnjerëzor ose degradues, por edhe nenin 1 të CEDAW<sup>71</sup>. Komiteti i CEDAW ka zbuluar më tej se ndalimi i dhunës me bazë gjinore (Neni 1 i CEDAW) si dhe ndalimi i diskriminimit ndaj grave në marrëdhëniet familjare (neni 16 i CEDAW) rezulton në detyrime pozitive të shtetit për të mbrojtur gratë nga dhuna në familje<sup>72</sup>. Prandaj, detyrimet e shteteve palë në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, në përgjithësi duhet të përmbajnë masat e përcaktuara në nenin 2 të CEDAW<sup>73</sup>. Gjithashtu, shteteve u kërkohet të miratojnë legjislacionin që ndalon dhe kriminalizon të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, për të siguruar qasje në shërbime mjekësore dhe këshilluese për viktimat, si dhe për të krijuar programe ndërgjegjësimi në mënyrë që të rrisin ndërgjegjësimin mbi këtë dhunë<sup>74</sup>.

43. CESCRC pranon se dhuna me bazë gjinore “është një formë diskriminimi që pengon aftësinë për të gëzuar të drejtat dhe liritë, përfshirë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, mbi bazën e barazisë”<sup>75</sup>. Si rezultat, qasja e CESCRC në lidhje me detyrimin e Shteteve Palë për të parandaluar dhunën ndaj grave është e ngjashme me atë të GJEDNJ-së, Komitetit për të Drejtat e Njeriut dhe Komitetit CEDAW. CESCRC thekson nevojën e zbatimit të masave të duhura për të parandaluar, hetuar, ndëshkuar dhe korrigjuar veprimet e dhunës ndaj grave nga aktorët privatë<sup>76</sup>. Për më tepër, CESCRC nënvizon faktin se dhuna në familje prek kryesisht gratë dhe sjell nevojën e detyrimeve mbrojtëse sipas nenit 10(1) të ICESCRC (të drejtat e familjes) në lidhje me nenin 3 të tij (të drejtat e barabarta të burrave dhe grave)<sup>77</sup>. Këto çështje të mbrojtjes përfshijnë krijimin e një vepre penale të veçantë të dhunës në familje, krijimin e qendrave të krizave ose strehëzave për viktimat, si dhe drejtimin e fushatave sensibilizuese<sup>78</sup>.

44. Si përfundim, UNCAT thekson se Shtetet Palë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë mbrojtjes së grupeve ose individëve të margjinalizuar, kur zbatojnë detyrimet themelore të saj, përkatësisht parandalimin e torturave dhe keqtrajtimit<sup>79</sup>. Për shkak të gjinisë

<sup>68</sup> CCPR, Komenti i Përgjithshëm 28: Neni 3 (Barazia e të Drejtave midis Burrave dhe Grave), 29 Mars 2000, paragrafët 8, 10, 11; CCPR, Komenti i Përgjithshëm 20: Neni 7 (Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues), 10 Mars 1992, paragrafi 13.

<sup>69</sup> CCPR, Komenti i Përgjithshëm 28: Neni 3 (Barazia e të Drejtave midis Burrave dhe Grave), 29 Mars 2000, paragrafi 3.

<sup>70</sup> Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 19: Dhuna ndaj grave (1992), paragrafi 7; Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 35: Dhuna me bazë gjinore ndaj grave, që përditëson rekomandimin 19, 26 korrik 2017, paragrafi 1.

<sup>71</sup> Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 19: Dhuna ndaj grave (1992), paragrafi 7.

<sup>72</sup> Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 35: Dhuna me bazë gjinore ndaj grave, që përditëson rekomandimin 19, 26 korrik 2017, paragrafi 16; Otto, Të drejtat e grave, në: Moeckli / Shah / Sivakumaran, Ligji Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut (2018), 319.

<sup>73</sup> Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm 35: Dhuna me bazë gjinore ndaj grave, që përditëson rekomandimin 19, 26 korrik 2017, paragrafi 21.

<sup>74</sup> Idem., paragrafët 26, 29, 30.

<sup>75</sup> CESCRC, Komenti i Përgjithshëm 16: Neni 3 (E drejta e barabartë e burrave dhe grave për gëzimin e të gjitha të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore), 11 gusht 2005, paragrafi 27.

<sup>76</sup> Idem.

<sup>77</sup> Idem.; Saul/Kinley/Mowbray, The International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights: Commentary, Cases and Materials (2014), Neni 10 ICESCRC, 733 – 734.

<sup>78</sup> Saul/Kinley/Mowbray, The International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights: Commentary, Cases and Materials (2014), Neni 10 ICESCRC, 734 – 735.

<sup>79</sup> CAT, Komenti i Përgjithshëm 2: Zbatimi i Nenit 2 nga Shtetet Palë, 24 Janar 2008, paragrafi 21.

së tyre, gratë dhe vajzat janë veçanërisht të prekshme nga torturat dhe keqtrajtimi<sup>80</sup>. Komiteti kundër Torturës vëren se një nga kontekstet, në të cilat femrat janë në rrezik, përfshin dhunën nga 'aktorët privatë' në shtëpi. Prandaj, dështimi i Shteteve Palë për të parandaluar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar ata në rastet e dhunës me bazë gjinore, siç është dhuna në familje, përbën shkelje të dispozitave të UNCAT<sup>81</sup>.

45. Vlera e shtuar e Konventës së Stambollit, në këtë tërësi instrumentesh të rëndësishme ndërkombëtare, qëndron tek fakti se është instrumenti i parë evropian që trajton në mënyrë gjithëpërfshirëse dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Ajo prezanton dispozita të reja që kërkojnë një strukturë institucionale specifike (përfshirë organet koordinuese kombëtare, mbledhjen e të dhënave dhe hulumtimin, përfshirjen e OJQ-ve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional) dhe parashikon masa konkrete parandaluese (nga arsimit dhe trajnimit të profesionistëve, deri në pjesëmarrjen e sektorit privat dhe medias). Gjithashtu, ajo përcakton masa mbrojtëse (nga shërbimet e përgjithshme deri në ato të specializuara, shërbimet për fëmijët dëshmitarë, informacioni ndaj viktimave), sipas ligjit material, por edhe masa civile, administrative dhe penale, si dhe masa mbrojtëse procedurale për viktimat. Konventa është instrumenti i parë evropian që i lidh këto fenomene në mënyrë të shprehur me stereotipat e dëmshme gjinore. Së fundmi, ajo krijon një organ të ri ndërkombëtar (GREVIO - shih VD, më poshtë) për të monitoruar zbatimin e masave të tilla<sup>82</sup>. Ratifikimi i Konventës së Stambollit, përveç shprehjes së angazhimit normativ ndaj vlerave të mbrojtura nga ky instrument, nënkupton edhe detyrimin mbi shtetet palë që të zbatojnë disa masa të reja dhe t'i nënshtrohen procedurës së monitorimit të GREVIO. Janë pikërisht këta elementë të rinj që kanë qenë objekt i debateve të tjera që lidhen me Konventën e Stambollit.

## V. Vlerësimi

### A. Konventa e Stambollit: A i nevojitet Armenisë?

46. Shpeshherë argumentohet se Konventa e Stambollit nuk nevojitet për arsyet e mëposhtme:

- a. sepse problemi i cili adresohet nuk ekziston në vendin në fjalë;
- b. sepse problemi tashmë mbulohet mjaftueshëm nga instrumentet juridike ndërkombëtare ekzistuese;
- c. sepse tashmë ekziston një kornizë e kënaqshme legjislativë (kombëtare), e cila lufton të gjitha format e dhunës ndaj grave.

47. Duhet të theksohet paraprakisht se asnjë nga këto tre argumente nuk paraqet një pengesë kushtetuese. Ato nuk lidhen me mundësinë e ratifikimit të Konventës së Stambollit, por përkundrazi me dëshirën për ta bërë këtë.

48. Pohimi i parë është kryesisht i një natyre faktike. Konventa e Stambollit synon të parandalojë, ndjekë penalisht dhe eliminojë të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë disproporcionale dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj tyre dhe promovimin e barazisë thelbësore midis burrave dhe grave.

<sup>80</sup> Idem., paragrafi 22.

<sup>81</sup> Idem., paragrafi 18.

<sup>82</sup> Shih gjithashtu Opininionin Ligjor mbi Konventën e Stambollit për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (CETS Nr. 210) - fushëveprimi i detyrimeve <https://www.coe.int/en/web/dlapil/-/legal-opinion-on-istanbul-convention>. Konventa e Stambollit përmendet gjithashtu në Progresin e KB të grave në botë 2019-2020, f.185: "Instrumenti më i fundit dhe i avancuar ligjorisht detyruar është Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e VAW dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit ), e cila hyri në fuqi në vitin 2014. Ajo detyron shtetet të ndërmarrin veprime për të parandaluar dhe mbrojtur personat ndaj të gjitha formave të VAW, të ndjekin penalisht ata që akuzohen për kryerjen e VAW dhe të miratojnë politika të integruara për të parandaluar dhe reaguar ndaj VAW." <https://www.unwomen.org/en/digital-library/progress-of-the-worlds-women>

49. Dhuna në familje është një fenomen i përhapur gjerësisht. Një nga studimet më gjithëpërfshirëse u krye në Evropë nga Agjencia e të Drejtave Themelore të BE-së në vitin 2014. Ai paraqiti të dhëna mbi masën, natyrën dhe pasojat e dhunës ndaj grave në të 28 vendet anëtare të BE-së. Rezultati i studimit ishte tronditës. Një në tre gra (33%) kishte përjetuar dhunë fizike dhe / ose seksuale që nga moshja 15 vjeç. Një në pesë gra (18%) kishte përjetuar kërcënime dhe çdo grua në dy (55%) ishte përballur me një ose më shumë forma të ngacmimit seksual. Ndërsa këto shifra janë alarmante në vetvete, ato bëhen edhe më të rënda kur merret në konsideratë që gratë, në përgjithësi nuk e raportojnë dhunën në polici dhe as në shërbime të tjera që mund të ofrojnë mbështetje, përfshirë organizatat që mbështesin viktimat. Tek sa këto statistika nuk kanë të bëjnë me Armeninë, ka arsye për të besuar se shtrirja e fenomenit në këtë shtet nuk do të ishte thjesht marginale<sup>83</sup>. OSBE-ja ka publikuar edhe një studim të ri në Mars 2019 (i cili gjithashtu nuk përfshin Armeninë), i cili konfirmon gjetjet më alarmante të këtij fenomeni.<sup>84</sup>

50. Siç vuri në dukje GJEDNJ-ja në Rastin Opuz kundër Turqisë<sup>85</sup>, “[...] çështja e dhunës në familje [...] është një problem i përgjithshëm që ka të bëjë me të gjitha shtetet anëtare, i cili nuk del gjithmonë në sipërfaqe, pasi shpesh ndodh brenda marrëdhënieve personale ose qarqeve të mbyllura”.

51. Pohimi i dytë ka të bëjë me mungesën e pretenduar të elementeve të reja të paraqitura nga Konventa e Stambollit, me objekt tashmë të adresuar në mënyrë adekuate nga instrumentet e tjera ligjore ndërkombëtare. Siç shihet më lart, është e vërtetë që ekzistojnë instrumente të ndryshme të të drejtave të njeriut, si në nivelin universal ashtu edhe në atë rajonal, të cilat janë ratifikuar nga Armenia dhe që trajtojnë disa nga çështjet e përfshira në Konventën e Stambollit. Për shembull, ndalimi i diskriminimit ndërmjet grave dhe burrave është i parashikuar në instrumentet e përgjithshme të të drejtave të njeriut (ICCPR - neni 3, KEDNJ - neni 14 dhe Protokolli 12) dhe i përpunuar më tej nga traktatet sektoriale të të drejtave të njeriut (CEDAW). Këto instrumente përmbajnë gjithashtu garanci të tjera të rëndësishme për promovimin e barazisë faktike dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor. Sidoqoftë, Konventa e Stambollit mbështetet në këto instrumente dhe është përqendruar posaçërisht në dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, të cilat nuk adresohen në mënyrë të qartë nga instrumentet e vjetra dhe siguron një mekanizëm specifik monitorimi. Kështu, Konventa e Stambollit paraqet një vlerë të shtuar në krahasim me traktatet ndërkombëtare të ratifikuara më parë në këtë fushë.

52. Pohimi i tretë thekson se Konventa e Stambollit nuk është e nevojshme sepse ka tashmë një kornizë të kënaqshme (legjislative) kombëtare për të luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave. Sipas mendimit të Komisionit të Venecias, prania e një infrastrukture të brendshme të shëndoshë për të mbrojtur të drejtat e njeriut nuk dëmton dëshirën për të patur kontroll të jashtëm. Këta janë elementë plotësues, jo kontradiktorë. Është e qartë se mbrojtja e të drejtave të njeriut duhet të bëhet kryesisht brenda rendit juridik të vendit. Kështu, i takon secilit shtet të vlerësojë, në dritën e të dhënave faktike<sup>86</sup>, se cilat janë mjetet më të mira për trajtimin e një dukurie në nivel kombëtar. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se mbikëqyrja e jashtme nga instrumentet ndërkombëtare duhet të konsiderohet e tepërt: (a) ratifikimi i një instrumenti ndërkombëtar mbart me vete një domethënie simbolike (autoritetet shtetërore dërgojnë një sinjal të fortë se janë seriozë në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve /

<sup>83</sup> Shih për shembull Bazën e të dhënave globale mbi dhunën ndaj grave (<http://evaw-global-database.unwomen.org/en/countries/asia/armenia>) dhe Human Rights Watch 2018 (<https://www.hrw.org/news/2018/01/12/armenia-little-protection-aid-domestic-violence-survivors>); CEDAW Përfundimi i vëzhgimeve në raportet e kombinuara të pesta dhe të gjashta periodike të Armenisë (2016) (<https://www.refworld.org/docid/583863b34.html>); *Analiza e boshllëkut të ligjit penal armen në dritën e standardeve të përcaktuara nga Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje* (<https://rm.coe.int/gap-analysis-armenian-law-eng/168075bac2>).

<sup>84</sup> <https://www.osce.org/secretariat/413237>

<sup>85</sup> GJEDNJ 9 Qershor 2009, Opuz kundër Turqisë, Aplikimi Nr. 33401/02, paragrafi 132.

<sup>86</sup> Shikoni, për shembull, Observatori Evropian mbi Femicidin, i filluar nga Universiteti i Maltës në vitin 2018 (<https://www.um.edu.mt/research/femicide>).

luftimin e një fenomeni të veçantë shoqëror), (b) e drejta ndërkombëtare mund të sigurojë një forum, në të cilin do të ndahen praktikat e mira dhe qasjet e autoriteteve kombëtare për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; për të diskutuar mangësitë e pretenduara dhe për të kontribuar në mënyrë aktive për përcaktimin e qasjeve të përbashkëta për veprim në nivelin ndërkombëtar, dhe (c) instrumenti ndërkombëtar mund të sigurojë mbrojtje shtesë në krahasim me kuadrin kombëtar.

53. Si përfundim, në lidhje me ekzistencën e nevojës aktuale për të ratifikuar Konventën e Stambollit, Komisioni i Venecias thekson se kjo nuk është një çështje e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Armenisë, por një çështje e dëshirës dhe mundësisë. Nuk është detyrë e Komisionit të Venecias të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të situatës në Armeni dhe të ligjit e praktikës kombëtare armene. Një vlerësim i situatës duhet të bëhet nga autoritetet vendase, duke marrë parasysh raportet e ekspertëve siç janë vëzhgimet përmbyllëse të CEDAW 2016 mbi raportet periodike të pesta dhe të gjashta të Armenisë<sup>87</sup> dhe Raporti i Këshillit të Evropës 2017 mbi Analizën *Gap* të së drejtës penale armene, në dritën e standardeve të përcaktuara nga Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.<sup>88</sup>

## **B. Konventa e Stambollit: A përmban terma dhe koncepte problematike?**

54. Konventa e Stambollit përdor terma dhe koncepte të caktuara që sipas disa mendimeve, mund të përplasen me terma dhe koncepte të përcaktuara në kushtetutat kombëtare. Kjo lidhet kryesisht me gjininë, identitetin gjinor, familjen, martesën dhe orientimin seksual.

55. Termi gjini, i cili përdoret në Konventën e Stambollit është përdorur tashmë nga një traktat tjetër i mëparshëm që merret me dhunën ndaj grave, pikërisht Konventa e vitit 1994 e Belém do Pará, e cila përkufizon dhunën ndaj grave në një mënyrë të ngjashme me Konventën e Stambollit.

56. Konventa e Stambollit e referon këtë koncept në raste të ndryshme (25 referenca të tilla). Së pari, ajo përfshin një përkufizim të termit gjini (shiko më lart, nenin 3 (c)) dhe dhunës me bazë gjinore (shih më lart, neni 3 (d)). Së dyti, ajo i fton shtetet të marrin një qasje të ndjeshme gjinore kur trajtojnë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

57. Është argumentuar se, duke prezantuar konceptin e gjinisë, Konventa e Stambollit mohon ekzistencën e dallimeve natyrore, biologjike midis grave dhe burrave<sup>89</sup>. Neni 12(1) i Konventës së Stambollit do të ishte kështu kali i Trojës i së ashtuquajturës ideologji gjinore që kërkon të ndryshojë plotësisht kulturën e shteteve dhe t'i detyrojë ata të mohojnë dallimet biologjike midis burrave dhe grave. Konventa e Stambollit kështu do të kundërshtonte kushtetutat kombëtare që njohin ekzistencën e dy gjinive (burra dhe gra). Sidoqoftë, ky interpretim nuk është i justifikuar.

58. Në një masë të madhe, mund të burojë nga konfuzioni midis termave gjini dhe seks, ose vetëm nga fakti se shumë gjuhë nuk përdorin fjalë të ndryshme për të përkufizuar këto dy koncepte të ndryshme. Megjithatë, dy gjuhët zyrtare të Konventës së Stambollit, anglishtja dhe frëngjishtja, bëjnë dallimin midis seksit (*sex/sexe*) dhe gjinisë (*gender/genre*). Ndërsa termi i parë ka të bëjë me një realitet biologjik, ai i dyti, në përputhje me përkufizimin e cituar më lart, ka të bëjë me pritshmëritë shoqërore të lidhura me këtë realitet. Ky përkufizim “shoqëror” nuk synon aspak të zëvendësojë përkufizimin biologjik. Për më tepër, edhe pse Konventa e Stambollit ofron një përkufizim të “gjinisë”, ajo nuk kërkon që Shtetet Palë ta përfshijnë këtë përkufizim në rendin e tyre juridik. Përkundrazi,

<sup>87</sup> <https://www.refworld.org/docid/583863b34.html>

<sup>88</sup> <https://rm.coe.int/gap-analysis-armenian-law-eng/168075bac2>

<sup>89</sup> Shi, p.sh., Roxana Stanciu, Gender is not a social construct, even if the Istanbul Convention says so, *European Dignity Watch*, 8 qershor 2018.

ajo i shërben atyre si një mjet për të interpretuar, kuptuar më mirë dhe rrjedhimisht zbatuar dispozitat e Konventës së Stambollit.

59. Siç përcakton Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, “qëllimi i kësaj dispozite është të arrijë zemrat dhe mendjet e individëve, të cilët përmes sjelljes së tyre, kontribuojnë për të përjetësuar format e dhunës të përfshira në fushëveprimin e kësaj Konvente”.<sup>90</sup> Në këtë mënyrë, dispozitat drejtohen kundër atyre stereotipave dhe paragjytimeve gjinore që stimulojnë dhe ushqejnë dhunën ndaj grave, për shembull ideja se gratë janë inferiore ndaj burrave dhe rrjedhimisht duhet të disiplinohen me anë të rrahjeve. Zgjedhja e masave të nevojshme për të sjellë një ndryshim në stereotipa të tilla të dëmshme i lihet vetë shteteve.

60. Konventa e Stambollit nuk sugjeron që e gjithë dhuna ndaj grave, e aq më tepër dhuna në përgjithësi, është me bazë gjinore. Ajo sugjeron se pritshmëritë shoqërore për veprimet që burrat dhe gratë duhet ose jo të bëjnë, janë ndër burimet kryesore të dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje. Për shkak të asaj që Preambula e Konventës së Stambollit e përshkruan si “marrëdhënie historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, të cilat kanë çuar në sundim të burrave, në diskriminimin e grave dhe ndalimin e përparimit të plotë të tyre” (paragrafi 9), gratë janë veçanërisht të ndjeshme ndaj dhunës, sepse dhuna ndaj tyre, sidomos në mjedisin shtëpiak, tradicionalisht është parë si e pranueshme. Për shembull, ligjet që lejojnë ose madje edhe kërkojnë, që burrat të “disiplinojnë” gratë e tyre nëpërmjet dhunës fizike, kanë qenë historikisht në fuqi në shumicën e vendeve të botës dhe janë shfuqizuar vetëm kohët e fundit<sup>91</sup>. Në mënyrë të ngjashme, të ashtuquajturat krime nderi, kur një anëtar i familjes vret, plagos ose dëmton një të afërm, i cili supozohet të ketë sjellë turp ose nderim për familjen, në të shumtën e rasteve janë të drejtuara kundër grave.<sup>92</sup>

61. Toleranca më e madhe ndaj dhunës ndaj grave, veçanërisht në mjedisin shtëpiak, pasqyron faktin se në shumicën e shoqërive tradicionale, gratë konsideroheshin inferiore ndaj burrave. Ato u dëbuan nga shumë fusha të jetës publike dhe u kufizuan në rrethet e tyre private. Grave duhej t’iu ‘tregohej vendi’ nga të afërmit e tyre ose anëtarët e tjerë meshkuj të shoqërisë. Gjatë shekullit të kaluar, kjo ndarje e rreptë gjinore është kapërcyer kryesisht në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës, legjislacioni i të cilave tani i konsideron burrat dhe gratë si të barabartë ligjërisht (p.sh. neni 30 i Kushtetutës së Armenisë). Megjithatë, ata që ushtrojnë dhunë ndaj grave, veçanërisht dhunë në familje, ende mund t’i përmbahen modeleve gjinore të trashëguara nga e kaluara ose të përfitojnë nga mjedisi, në të cilin këto modele nuk janë tejkaluar plotësisht.

62. Në reflektim të kësaj situate, Konventa e Stambollit pranon se, megjithëse dhuna ndaj grave është një fenomen me shumë shkaqe, ajo ka një dimension strukturor, pasi shpesh lidhet me diskriminimin ndaj grave dhe pozicionin e tyre të veçantë apo inferior në shoqëri. Kështu, Konventa inkurajon shtetet të mos e anashkalojnë këtë aspekt dhe të marrin një perspektivë të ndjeshme gjinore. Ajo gjithashtu inkurajon shtetet të adresojnë shkaqet strukturore të dhunës ndaj grave duke ndërmarrë “masat e nevojshme për të promovuar ndryshimet në sjelljet sociale dhe kulturore të grave dhe burrave, me qëllim zhdukjen e paragjytimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose në role stereotip për gratë dhe burrat” (neni 12(1)).

63. Kushtetuta e Armenisë nuk i referohet konceptit të gjinisë. Sidoqoftë, ajo garanton barazinë e burrave dhe grave (neni 30) dhe parashikon “promovimin e barazisë

<sup>90</sup> Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafi 85.

<sup>91</sup> J. C. Campbell, Beating of wives: a cross-cultural perspective, *Victimology*, Vol. 10, 1985, pp. 174-85; David Peterson, Wife Beating: An American Tradition, *The Journal of Interdisciplinary History*, Vol. 23, 1992, pp. 97-118; Lorna McLean, Deserving Wives and Drunken Husbands: Wife Beating, Marital Conduct, and the Law in Ontario, 1850-1910, *Histoire sociale/Social History*, Vol. 35, 2002, pp. 59-81.

<sup>92</sup> Shih Hossein, Sara, Welchman, Lynn (eds), *'Honour': Crimes, Paradigms and Violence Against Women*, Zed Books, 2005.

faktike midis grave dhe burrave” (neni 86 (4)), si një nga objektivat e politikës shtetërore. Eliminimi i dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe promovimi i masave që synojnë arritjen e saj, përfshirë masat që kërkojnë të ndryshojnë stereotipat e dëmshme gjinore, është plotësisht në përputhje me këtë rregullore kushtetuese.

64. Një koncept tjetër që pretendohet të jetë i diskutueshëm është ai i identitetit gjinor. Sipas përshkrimeve më të përdorura të këtij koncepti, termi ‘identitet gjinor’ mund të konsiderohet se përfshin jo vetëm individë të tillë si persona transeksualë që kanë ndryshuar seksin e tyre, por edhe persona që zgjedhin mjete të tjera për të shprehur gjininë e tyre<sup>93</sup>. Kjo përfshin transvestitët, transgjinorët, si dhe grupet e tjera të personave që nuk përfshihen në kategoritë binare mashkull ose femër, shpesh të referuara si ‘gjini e tretë’<sup>94</sup>. Sidoqoftë, në Konventën e Stambollit nuk ka asnjë përkufizim të identitetit gjinor, i cili përmendet vetëm një herë, në nenin 4(3), i cili parashikon klauzolën e mosdiskriminimit, duke thënë se “zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, në veçanti masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo baze siç është /... / identiteti gjinor /... /”. Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit thjesht bën të qartë se identiteti gjinor në këtë kontekst i referohet situatës në të cilën “gjinia me anë të së cilës identifikohen individët, nuk është në përputhje me seksin që u është caktuar atyre gjatë lindjes”<sup>95</sup>.

65. Është e rëndësishme të theksohet se Konventa e Stambollit nuk kërkon që Shtetet Palë të marrin masa për të njohur këto kategori të ndryshme personash ose t’u japin atyre ndonjë status të veçantë juridik. Thjesht konfirmon se identiteti gjinor renditet si bazë për diskriminim, krahas seksit, gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik, origjinës kombëtare ose shoqërore, përkatësia e një pakice kombëtare, pronës, lindjes, orientimit seksual, moshës, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, statusit martesor, statusit të migrantit ose refugjatit, ose çfarëdo statusi tjetër. Kjo do të thotë se një individ nuk mund t’i mohohet mbrojtja nga dhuna ose statusi i viktimës dhe të drejtat që rrjedhin nga ky status, për shkak të identitetit të tij gjinor. Personat jo binarë, transgjinorë, transeksualë dhe të tjerë, kanë të njëjtën të drejtë në lidhje me të si çdo person tjetër (jo më shumë ose më pak të drejta).

66. Ky akt duket se është plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Armenisë. Ai konfirmon se, siç thekson neni 28 i Kushtetutës, “të gjithë do të jenë të barabartë para ligjit” dhe në mbështetje të nenit 29 të kësaj Kushtetute se “diskriminimi për shkak të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, etnisë ose origjinës shoqërore, veçorive gjenetike, gjuhës, fesë, botëkuptimit, pikëpamjeve politike, përkatësisë në një pakice kombëtare, statusit pasuror, lindjes, paafësisë, moshës, ose rrethanave të tjera personale apo shoqërore, do të ndalohej”. Megjithëse identiteti gjinor nuk përmendet në mënyrë të qartë tek arsyet e ndaluara, Gjykata Kushtetuese e Armenisë mund të konsiderojë se ai përfshihet në “rrethana të tjera personale”. Është e vështirë të shihet se si ndalimi i diskriminimit bazuar në identitetin gjinor në fushën e mbrojtjes nga dhuna dhe ndoshta në pothuajse të gjitha fushat e tjera, mund të konsiderohet si jokushtetues. Nga ana tjetër, është shumë më e lehtë të dallohet se e tillë mund të jetë situata e kundërt (nëse mbrojtja ndaj dhunës nuk u është ofruar disa individëve për shkak të identitetit të tyre gjinor).

67. Një nga konceptet kryesore që ka shkaktuar polemika, në lidhje me Konventën e Stambollit, është koncepti i familjes. Pretendohet se Konventa e Stambollit parashikon përcaktime të marrëdhënieve midis partnerëve që mund të jenë të papajtueshme me përcaktimet e përfshira në kushtetutat kombëtare<sup>96</sup>. Megjithatë, Konventa nuk përmban

<sup>93</sup> Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe Këshilli i Evropës, Manual për ligjin evropian kundër diskriminimit (2018), 171.

<sup>94</sup> Idem.; *Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit (2011), paragrafi 53.*

<sup>95</sup> Ibid.

<sup>96</sup> Ky ishte një nga argumentet që u përdor për të ndaluar procesin e ratifikimit të Konventës së Stambollit në Sllovaki, shih *Istanbulský dohovor rozpútal v parlamente diskusiu, poslanci sa v názoroch rozchádzajú*, WebNoviny, 28. marca 2019.



ndonjë përkufizim të familjes, as të marrëdhënieve midis partnerëve të të njëjtit seks, madje as nuk e promovon ndonjë formë marrëdhëniesh të tilla (shiko nën C, më poshtë).

68. Nocioni i familjes në Armeni trajtohet nga neni 16 i Kushtetutës, i cili e sheh mbrojtjen e saj si një element themelor të rendit kushtetues: “Familja – duke qenë njësi natyrore dhe themelore e shoqërisë, baza për ruajtjen dhe riprodhimin e popullatës, si dhe amësia dhe fëmijët - do të jenë nën një mbrojtje dhe kujdes të veçantë të Shtetit.”

69. Nocioni i familjes është i lidhur ngushtë me nocionin e martesës. Në Armeni, liria për t'u martuar përcaktohet në nenin 35 të Kushtetutës, si më poshtë:

*“1. Një grua dhe një burrë që kanë arritur moshën e martesës kanë të drejtë të martohen dhe të formojnë një familje, nëpërmjet shprehjes së lirë të vullnetit të tyre. Moshë dhe procedura e martesës dhe divorcit përcaktohen me ligj.*

*2. Një grua dhe një burrë kanë të drejta të barabarta sa i përket martesës, gjatë martesës dhe në shpërbërjen e saj.*

*3. Liria për t'u martuar mund të kufizohet vetëm me ligj, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe moralit.”<sup>97</sup>*

70. Nga sa më sipër rrjedh se neni 35 i Kushtetutës së Armenisë përcakton se martesë përbën një bashkim midis një burri dhe një gruaje, të cilët kanë arritur moshën e caktuar për martesë. Ata kanë të drejtë të krijojnë një familje e cila, sipas nenit 16 të Kushtetutës së Armenisë, “do të jetë nën mbrojtjen dhe kujdesin e veçantë të Shtetit”. Kjo do të thotë që Kushtetuta aktuale e Armenisë nuk lejon martesë midis personave të të njëjtit seks.

71. Konventa e Stambollit përmend martesën vetëm në kontekstin e martesës së detyruar (neni 37). Ajo nuk krijon një detyrim për shtetet palë të legalizojnë martesën midis personave të të njëjtit seks (shiko nën C, më poshtë) ose të marrin ndonjë masë tjetër në lidhje me personat LGBT (përveç mos përjashtimit të tyre nga mbrojtja e dhënë nga Konventa për viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje). Konventa e Stambollit nuk kundërshton në asnjë mënyrë kushtetutat kombëtare që përcaktojnë martesën, si bashkim midis një gruaje dhe një burri - që është edhe rasti i Armenisë, siç shihet më lart.

72. Një koncept tjetër që ka ngjallur polemika është koncepti i orientimit seksual. Ky term mund të shihet se i referohet individëve, të cilët janë anëtarë të një pakice seksuale, siç janë homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët (LGBT), si dhe individët që e konsiderojnë veten heteroseksual.<sup>98</sup>

73. Duhet të bëhet e qartë se, nëse një traktat (ose ndonjë akt tjetër ligjor mbi atë çështje) nuk kundërshton ekzistencën, sipas ligjit të brendshëm të disa shteteve, e një të drejte ose pretendimi të caktuar juridik, kjo nuk do të thotë se vetë traktati vendos detyrim pozitiv ndaj Shteteve (të cilat nuk e pranojnë ekzistencën e kësaj të drejte juridike) për të krijuar në mënyrë aktive një nocion të tillë në rendin e tyre juridik të brendshëm. Në këtë drejtim, gjykimi i GJEDNJ-së në Rastin e Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>99</sup> mund të shërbejë si shembull. Aplikuesja ishte e paralizuar dhe në fazat e avancuara të një sëmundjeje të neuroneve motorike. Ajo pretendoi se ndalimi i vetëvrasjes së asistuar në ligjin anglez shkelte të drejtën e saj për jetën. Gjykata theksoi se “nuk ishte e bindur që e drejta e jetës e garantuar nga neni 2 mund të interpretohej në aspektin negativ”, dhe “se neni 2 nuk mund të interpretohej në drejtimin diametralisht të kundërt, konkretisht si një e drejtë për të vdekur” dhe se “asnjë e drejtë për të vdekur, qoftë nga duart e një personi të tretë ose me ndihmën e një autoriteti publik, nuk mund të burojë nga neni 2 i Konventës”. GJEDNJ

<sup>97</sup> <https://www.president.am/en/constitution-2015/>

<sup>98</sup> O'Flaherty, *Sexual Orientation and Gender Identity*, in: Moeckli / Shah / Sivakumaran, *International Human Rights Law* (2018), 298; European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, *Handbook on European non-discriminatory law* (2018), 176.

<sup>99</sup> GJEDNJ, Aplikimi Nr. 2346/02, 29 Prill 2002.

nuk theksoi që sistemet ligjore që pranojnë vetëvrasjen e asistuar do të ishin në kundërshtim me kërkesat e Konventës. Ajo vendosi se personi nuk mund të përdorë KEDNJ-në për të imponuar një detyrim pozitiv ndaj shteteve për të përfshirë një nocion të tillë në sistemet e tyre ligjore.

74. Një traktat ndërtohet në mënyrë të tillë që të jetë i zbatueshëm për sisteme shumë të ndryshme juridike. Prandaj, gjatë negociatave për një traktat të tillë, hartuesit shpesh zgjedhin një formulim të caktuar për të lejuar zbatimin e tij në sisteme të ndryshme ligjore. Për shembull, Konventa e Stambollit zbatohet në mënyrë të barabartë për vendet që e pranojnë ligjërish, por edhe për vendet që nuk e pranojnë martesën e të njëjtit seks dhe / ose birësimin e një fëmije nga homoseksualët. Konventa e Stambollit nuk kundërshton sisteme të tilla juridike, por kjo nuk do të thotë që ajo i kërkon shteteve, të cilat nuk kanë pranuar nocione të tilla, t'i përfshijnë ato në rendin e tyre juridik.

### **C. Konventa e Stambollit: A kërkojnë ndryshime ligjore specifike?**

75. Përveç përmbajtjes së termave dhe koncepteve problematike, pretendohet se Konventa e Stambollit kërkon disa ndryshime legjislativë që mund të kundërshtojnë kushtetutat kombëtare. Ndryshimet kryesore të parashikuara në këtë kontekst kanë të bëjnë me martesën midis personave të të njëjtit seks, edukimin dhe raportimin nga profesionistët.

76. Për çështjen e martesës midis personave të të njëjtit seks, të diskutuar në pikën B më lart, duhet shtuar se është argumentuar në mënyrë të përsëritur se ratifikimi i Konventës së Stambollit do të rezultonte në legalizimin e kësaj martese. Ky argument luajti një rol të rëndësishëm në refuzimin e propozimit të qeverisë për të ratifikuar Konventën e Stambollit në Sllovaki, si dhe ka ngjallur diskutime në debatin publik edhe në vendet e tjera<sup>100</sup>. Është e paqartë në cilën dispozitë ligjore është bazuar ky argument, duke qenë se Konventa nuk u referohet fare homoseksualëve. Orientimi seksual përmendet vetëm në klauzolën e mosdiskriminimit (neni 4(3)) dhe martesa përmendet në lidhje me martesën e detyruar (neni 37).

77. Siç u përmend më lart në pikën B, nuk ka asnjë detyrim në Konventë për Shtetet Palë, për të legalizuar martesën midis personave të të njëjtit seks. Në këtë mënyrë, nuk ekziston asnjë dispozitë e saj që bie në kundërshtim me Kushtetutën e Armenisë.

78. Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias shton se çështja e martesës midis personave të të njëjtit seks është trajtuar vazhdimisht nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Gjykata ka shprehur mendimin se “megjithëse institucioni i martesës ka pësuar ndryshime të mëdha shoqërore që nga miratimi i Konventës, / ... / nuk ka konsensus evropian në lidhje me martesën midis personave të të njëjtit seks”.<sup>101</sup> Kjo pyetje mbetet “subjekt i ligjeve kombëtare të Shteteve Kontraktuese”.<sup>102</sup> Konventa e Stambollit nuk e ndryshon këtë situatë.

79. Komisioni i Venecias gjithashtu kthen vëmendjen ndaj vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Armenisë të 22 shkurtit 2002 në lidhje me ratifikimin e KEDNJ-së:

*“1. Detyrimet e deklaruara në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të nënshkruara në 4 nëntor 1950 në Romë, në Protokollin e kësaj Konvente të nënshkruar në 20 Mars 1952 në Paris, në Protokollin Nr. 4 "Për disa të drejta dhe liri të krahas atyre të përfshira tashmë në konventë dhe në Protokollin e parë të saj, të ndryshuar me Protokollin Nr. 11", nënshkruar më 16 shtator 1963 në Strasburg dhe në Protokollin Nr. 7 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të nënshkruar më*

<sup>100</sup> Jan Čulík, Top official of the Catholic Church in Czechia rails against a convention guaranteeing women's human rights, *Britské listy*, 6 tetor 2018.

<sup>101</sup> GJEDNJ, Schalk dhe Kopf kundër Austrisë, Aplikimi Nr. 30141/04, 24 Qershor 2010, paragrafi 58.

<sup>102</sup> GJEDNJ, Chapin et Charpentier kundër Francës, Aplikimi Nr. 40183/07, 9 Qershor 2016, paragrafi 36.

22 nëntor 1984 janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Armenisë.

2. Sipas paragrafit 2 të nenit 102 ky vendim do të jetë përfundimtar, nuk i nënshtrohet rishikimit dhe hyn në fuqi menjëherë pas botimit.<sup>103</sup>

Ky vendim është në fuqi edhe sot.

80. Në lidhje me arsimin në Armeni, “e drejta dhe detyrimi i prindërve për t’u kujdesur për /.../ edukimin e fëmijëve të tyre” është parashikuar në nenin 36(1) të Kushtetutës<sup>104</sup> dhe e drejta për arsim garantohet sipas nenit 38 të Kushtetutës<sup>105</sup>. Këto të drejta dhe detyrime të prindërve armenë që kanë të bëjnë me arsimimin e fëmijëve të tyre sqarohen dhe përmirësohen nga një shumëllojshmëri instrumentesh ndërkombëtare që theksojnë se prindërit kanë të drejtë të zgjedhin një edukim fetar dhe moral për fëmijët e tyre në përputhje me diktatet e ndërgjegjes së tyre.<sup>106</sup>

81. Arsimi trajtohet nga neni 14 i Konventës së Stambollit, i cili përcakton se “Kur është e përshtatshme, palët ndërmarrin hapat e nevojshme për të përfshirë material mësimor për çështje të tilla si barazia midis grave dhe burrave, rolet gjinore pa stereotipa, respekti i ndërsjellë, zgjidhja e paqte e konflikteve në marrëdhëniet personale, dhuna me bazë gjinore ndaj grave dhe e drejta për integritet personal, të përshtatur me aftësinë evoluese të nxënësve, në kurrikula zyrtare dhe në të gjitha nivelet e arsimit” (paragrafi 1). Kjo dispozitë dyshohet se shkaktoi frikë në lidhje me të drejtën e prindërve për të edukuar fëmijët e tyre sipas preferencave të tyre, si dhe detyrimin e shtetit për të përfshirë kurse për identitetin gjinor ose orientimin seksual në programet shkollore.

82. Duhet nënvizuar se neni 14 i Konventës së Stambollit nuk ndërhyr në të drejtën e prindërve për të edukuar fëmijët e tyre sipas preferencave të tyre. Kjo çështje, në të vërtetë, mbetet jashtë qëllimit të Konventës së Stambollit. Neni 14 i kësaj Konvente thjesht kërkon që Shtetet Palë, kur vlerësohet e përshtatshme, të përfshijnë materiale mësimore për çështjet e lartpërmendura në programet shkollore. Kjo bëhet në reflektim të faktit se, siç u theksua, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje shpesh burojnë nga stereotipa dhe paragjykimet të dëmshme gjinore që janë pjesë e qëndrimeve, bindjeve dhe modeleve të sjelljes së njerëzve dhe se qëndrimet, bindjet dhe modelet e sjelljes “janë formuar shumë herët në jetë”.<sup>107</sup>

83. Në Ligjin e saj për Arsimin<sup>108</sup>, Armenia deklaron se “natyra humanitare e arsimit, përparësia e vlerave universale, jeta dhe shëndeti i njeriut, zhvillimi i lirë dhe gjithëpërfshirës i një individi, nxitja e vetëdijes civile, dinjitetit kombëtar, patriotizmit, ligjshmërisë dhe perspektivës së botës mjedisore.” (Neni 5 (1)) janë parimet kryesore të politikës shtetërore në fushën e arsimit. Kjo tregon se, megjithëse arsimit i nënshtrohet “parimit të demokracisë” (neni 5 (3) i Ligjit për arsimin), ai duhet të bazohet në vlerat në të cilat mbështetet rendi kushtetues i vendit. Vlera të tilla janë dinjiteti njerëzor, respektimi i

<sup>103</sup> Vendimi CCD - 350 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Armenisë i 22 shkurtit 2002, në çështjen për vendosjen e çështjes së konformitetit të detyrimeve të përcaktuara në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të nënshkruar më 4 nëntor 1950 në Romë, në Protokollin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të nënshkruar më 20 Mars 1952 në Paris, në Protokollin Nr. 4 "për disa të drejta dhe liri të caktuara, përveç atyre të përfshira tashmë në Konventë dhe në Protokollin e Parë të tij, ndryshuar me Protokollin Nr. 11" nënshkruar më 16 shtator 1963 në Strasburg, dhe në Protokollin Nr. 7 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar më 22 nëntor 1984 me Kushtetutën e Republikës së Armenisë.

<sup>104</sup> “Neni 36. Të drejtat dhe detyrimet e prindërve

1. Prindërit kanë të drejtë dhe detyrim të kujdesen për rritjen, edukimin, shëndetin dhe zhvillimin gjithëpërfshirës dhe harmonik të fëmijëve të tyre.”

<sup>105</sup> “Neni 38. E drejta për arsim

1. Të gjithë kanë të drejtë të arsimohen. Programet dhe kohëzgjatja e arsimit të detyrueshëm përcaktohen me ligj. Arsimit i mesëm në institucionet arsimore shtetërore është pa pagesë.

2. Gjithkush ka të drejtë të marrë, në rastet dhe mënyrën e përcaktuar me ligj, arsimin falas në institucionet e larta shtetërore dhe institucionet e tjera të arsimit profesional, në bazë të konkurrencës.

3. Institucionet e arsimit të lartë, brenda kornizës së përcaktuar me ligj, kanë të drejtën e vetëqeverisjes, duke përfshirë lirinë akademike dhe kërkimore.”

<sup>106</sup> Kelly, James P., “Human Rights Education, Religion, and Parental Choice in Education,” *Engage* (1 Maj 2005).

<sup>107</sup> Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafi 94.

<sup>108</sup> Ligji i Republikës së Armenisë për Arsimin, miratuar nga Asambleja Kombëtare më 14 Prill 1999.

të drejtave të njeriut e lirive themelore dhe barazia e të gjithë qytetarëve, përfshirë barazinë midis burrave dhe grave (nenet 3, 28 dhe 30 të Kushtetutës së Armenisë).

84. Neni 14 i Konventës së Stambollit nuk përcakton ndonjë mënyrë specifike që duhet të zbatohet në lidhje me arsimin, për sa i përket çështjeve të Konventës. Në fakt, shprehja “aty ku është e përshtatshme” në dispozitë tregon që Konventa e Stambollit ua atribuon këtë Shteteve Palë jo vetëm mënyrën e edukimit, por edhe për sa i përket shtrirjes së saj. I takon pikërisht këtyre të fundit “të vendosin se cili lloj shkollimi dhe për cilën grupmoshë të nxënësve ata e konsiderojnë atë material mësimor të përshtatshëm”<sup>109</sup> dhe nëse e konsiderojnë të përshtatshme për të patur materiale të tilla mësimore.

85. Komisioni i Venecias konkludon: duke qenë se vlerat e promovuara nga Konventa e Stambollit janë në përputhje me vlerat kushtetuese të Armenisë dhe se Shtetet Palë kanë diskrecion të madh për të vendosur se si (deri në çfarë mase dhe në çfarë mënyre) ata do të edukojnë popullsinë e tyre për çështje që mbulohen nga Konventa, duket se nuk ka kundërshtim midis nenit 14 të Konventës së Stambollit dhe Kushtetutës së Armenisë.

86. *Raportimi nga profesionistë* trajtohet në nenin 28 të Konventës së Stambollit, i cili përcakton se “Palët marrin masat e nevojshme për të siguruar që rregullat e konfidencialitetit të vendosura nga ligji i brendshëm për disa profesionistë, në kushte të përshtatshme nuk përbëjnë pengesë për mundësinë e raportimit të tyre para organizatave ose autoriteteve kompetente, nëse ata kanë motive të arsyeshme të besojnë se një veprim i dhunshëm i mbuluar nga qëllimi i kësaj Konvente është kryer apo pritet të kryhet”. Në disa vende, dispozita ka ngjallur frikë tek grupe të caktuara profesionale, veçanërisht avokatët<sup>110</sup>, pasi mund të rezultojë në heqjen e konfidencialitetit profesional dhe futjen në ligjin kombëtar të detyrimit për raportim. Në Armeni, konfidencialiteti i komunikimit, në kuptimin e përgjithshëm, garantohet nga neni 33 i Kushtetutës dhe rregullat që lidhen me profesione specifike gjenden në legjisllacionin e zakonshëm dhe kodet profesionale.

87. Sidoqoftë, ky interpretim nuk është i justifikuar. Qëllimi kryesor i nenit 28 të Konventës së Stambollit nuk është që të nxisë shtetet të heqin dorë nga konfidencialiteti profesional, por t'i nxisë ata të hapin rrugën për profesionistë të caktuar, kryesisht në sektorin e shëndetësisë, të raportojnë për raste të dyshuara të akteve të rënda të dhunës kundër grave ose dhunës në familje, pa rrezikuar të dënohen për shkelje të konfidencialitetit. Në mënyrë të ngjashme me nenin 14, neni 28 i Konventës së Stambollit u jep diskrecion Shteteve Palë të vendosin se cilat masa duhet të marrin dhe në cilat “kushte të përshtatshme”, për të bërë të mundur raportimin nga profesionistët. Është e rëndësishme të shtohet se, siç e bën të qartë edhe Raporti Shpjegues, Konventa e Stambollit nuk parashikon raportim të detyrueshëm<sup>111</sup>; “Ajo thjesht u jep këtyre personave mundësinë që ta bëjnë këtë pa rrezikuar të shkelin konfidencialitetin.”<sup>112</sup> Prandaj Konventa nuk kërkon nga Shtetet Palë të miratojnë akte që mund të shihen si të papajtueshme me dispozitat kushtetuese mbi konfidencialitetin e komunikimit.

#### **D. Konventa e Stambollit: a krijon ajo një organ me kompetenca të tepërta?**

88. Konventa e Stambollit u kërkon Shteteve Palë të marrin masa për zbatimin e politikave që synojnë parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, si dhe dhunës në familje. Ajo gjithashtu nxit shtetet të bashkëpunojnë në këtë fushë me njëri-tjetrin. Për të monitoruar gjendjen e zbatimit, ajo krijon një organ të ri ndërkombëtar, Grupin e ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

<sup>109</sup> *Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafi 95.*

<sup>110</sup> *Istanbulská úmluva vadí nejen církví, ale i advokátům. Bojí se prolomení mlčenlivosti, Aktuálně.cz, 24 tetor 2018.*

<sup>111</sup> Disa shtete prezantojnë raportim të detyrueshëm në rendin e tyre juridik, siç është rasti i Armenisë. Neni 335 i Kodit Penal të Armenisë parashikon dëshkrimin për të raportuar si një krim të rëndë ose veçanërisht të rëndë, duke i dhënë atij një dënim deri në dy vjet burgim.

<sup>112</sup> *Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, paragrafi 147.*

(GREVIO). Ky i fundit është një organ ekspert i përbërë nga minimumi 10-15 anëtarë, i zgjedhur nga Komiteti i Palëve. Ai merr në konsideratë raportet kombëtare (pyetësorin) të paraqitur nga Shtetet Palë dhe nxjerr raporte dhe përfundime. Ai gjithashtu mund të miratojë rekomandime të përgjithshme. Sipas nenit 68(9) dhe 68(14), GREVIO mund të organizojë vizita në shtete, gjatë së cilave anëtarët e tij, si dhe anëtarët e tjerë të delegacionit, gëzojnë - në bazë të nenit 66(7) - privilegje dhe imunitete të caktuara. Këto privilegje dhe imunitete janë renditur në Shtojcën e Konventës së Stambollit dhe përfshijnë:

1. imuniteti nga arrestimi ose ndalimi personal, nga konfiskimi i bagazheve personale dhe imuniteti nga procesi ligjor i çdo lloji në lidhje me fjalët e thëna ose të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera në cilësinë e tyre zyrtare;
2. përjashtimi nga çdo kufizim i lirisë së lëvizjes së tyre që nga dalja nga vendi dhe kthimi në vendin e tyre të rezidencës, si dhe hyrja dhe dalja nga vendi në të cilin ata ushtrojnë funksionet e tyre; nga regjistrimi në vendin që po vizitojnë ose përmes së cilit ata kalojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre;
3. të njëjtat lehtësira në lidhje me doganat dhe kontrollin e këmbimit, si ato që u janë dhënë përfaqësuesve të qeverive të huaja në detyrë zyrtare të përkohshme;
4. paprekshmëria e të gjitha dokumenteve në lidhje me vlerësimin e zbatimit të Konventës.

89. Privilegjet dhe imunitetet jepen “për të mbrojtur ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në interes të GREVIO dhe jo për përfitimin e tyre personal” (paragrafi 6). Imuniteti nga procedimi ligjor në lidhje me fjalët e thëna ose të shkruara dhe të gjitha veprimet e bëra prej tyre për kryerjen e detyrave do të vazhdojnë të akordohen pasi personat në fjalë nuk janë më të angazhuar në kryerjen e këtyre detyrave.

90. Kompetencat e GREVIO dhe veçanërisht privilegjet dhe imunitetet që u janë dhënë anëtarëve të saj, ndonjëherë janë kritikuar si një dorëzim de fakto i sovranitetit kombëtar tek një organ të jashtëm jo i zgjedhur<sup>113</sup>. Megjithatë, nuk ka arsye për një vlerësim të tillë. GREVIO nuk ka ndonjë kompetencë të pazakontë për një organ ndërkombëtar. Në fakt, kompetencat e tij janë mjaft të kufizuara, pasi ato nuk përfshijnë, për shembull, të drejtën për të marrë një kërkesë ndër-shtetërore ose individuale. Për më tepër, GREVIO nuk mund të nxjerrë përfundime detyruese dhe rekomandimet e bazuara në raportet e saj do të nxirren nga Komiteti i Palëve, dhe jo nga vetë GREVIO. Prania dhe shtrirja e privilegjeve dhe imuniteteve nuk është gjithashtu e pazakontë. Shtojca bazohet në Marrëveshjen e përgjithshme për privilegjet dhe imunitetet e Këshillit të Evropës, në fuqi që nga viti 1952, duke marrë përsipër disa nga dispozitat e saj për t'i bërë ato të zbatueshme drejtpërdrejt për shtetet, të cilat nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës (dhe shtetet palë në Marrëveshjen e Përgjithshme), por mund të vendosin të aderojnë në Konventën e Stambollit. Kështu që nuk ka de fakto, e aq më pak de jure, dorëzim të sovranitetit kombëtar tek një organ i jashtëm i përfshirë në ratifikimin e Konventës së Stambollit.

### **E. Konventa e Stambollit: a parashikon azil të bazuar në çështjet gjinore?**

91. Kapitulli VII i Konventës së Stambollit merret me migracionin dhe azilin dhe përmban një numër detyrimesh pozitive për shtetet palë, veçanërisht në nenin 60 të tij, i cili thotë se:

*“Neni 60 – Kërkesa për azil mbi bazat e çështjeve gjinore*

1. *Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të siguruar që dhuna me bazë gjinore ndaj grave mund të njihet si një formë persekutimi në kuptimin e nenit 1, A(2), të Konventës së vitit 1951, në lidhje me statusin e refugjatëve dhe si një formë e dëmit serioz që kërkon mbrojtje shtesë.*
2. *Palët sigurojnë që secilës prej motiveve të Konventës t'i jepet një interpretim i ndjeshëm gjinor dhe kur vërtetohet se përndjekja vjen si pasojë e një ose më shumë prej këtyre*

<sup>113</sup> Tomáš Zdechovský, Proč Istanbulskou úmluvu kritizují právníci po celé Evropě a v ČR se o tom mlčí? iDnes.cz, 19 tetor 2018.

*motiveve, aplikantëve do t'u jepet statusi i refugjatit sipas instrumenteve përkatëse të aplikueshme.*

3.  *Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të zhvilluar procedura pranimi dhe shërbime mbështetëse me ndjeshmëri gjinore ndaj azilkërkuësve, si dhe udhëzime dhe procedura të tilla azili, të cilat përfshijnë përcaktimin e statusit të refugjatit dhe aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare.”*

92. Paragrafi 310 i Raportit Shpjegues e bën të qartë se neni 60 i Konventës së Stambollit synon të kodifikojë *inter alia* zhvillimet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së duke pranuar se disa forma të dhunës ndaj grave mund të kërkojnë mbrojtje. Një shembull i qartë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ është çështja e N. kundër Suedisë<sup>114</sup>, në të cilën Gjykata vuri në dukje se sipas raportimeve, rreth 80% e grave afgane ishin viktime të dhunës në familje, akte të cilat autoritetet i konsideronin të ligjshme dhe prandaj nuk ndiqeshin penalisht. Paragrafi 55 i gjykimit N. kundër Suedisë vë në dukje se:

*“Së pari, Gjykata vëren se gratë janë në rrezik të veçantë të keqtrajtimit në Afganistan, nëse vlerësohet se nuk përputhen me rolet gjinore që iu atribuohen atyre nga shoqëria, tradita dhe madje edhe sistemi ligjor. UNHCR vërejtë që gratë afgane, të cilat kanë adoptuar një mënyrë jetese më pak konservatore, siç janë ato që kthehen nga emigracioni në Iran ose Evropë, vazhdojnë të perceptohen si në shkelje të normave të ngulitura sociale e fetare dhe si rezultat, mund t'i nënshtrohen dhunës në familje dhe formave të tjera të ndëshkimit, duke filluar nga izolimi dhe stigmatizimi deri në krime nderi, për ato që akuzohen se sjellin turp për familjet, komunitetet ose fiset e tyre. Kundërvajtjet faktike ose të perceptuara të kodit të sjelljes shoqërore përfshijnë jo vetëm sjelljen në kontekstin e një familjeje ose të një komuniteti, por edhe orientimin seksual, ndjekjen e një karriere profesionale dhe mosmarrëveshjet e thjeshta të jetës familjare.”*

93. Në të njëjtën mënyrë, Konventa e Stambollit u bën thirrje shteteve palë të pranojnë se dhuna e tillë si përdhunimi, gjymtimi i organeve gjinitale të grave, dhuna që lidhet me pajën, dhuna e rëndë familjare ose trafikimi, mund të përbëjnë rrezik për përndjekje ose dëm serioz dhe çojnë në dhënien e statusit të rezidencës. Ratifikimi i Konventës së Stambollit nuk nënkupton që e gjithë dhuna me bazë gjinore konsiderohet automatikisht si “dëm serioz” ose që adoptimi i një qasjeje gjinore të ndjeshme do të thotë që të gjitha gratë automatikisht do të kenë të drejtën e statusit të refugjatit. Ajo thjesht pranon se gratë mund të përballen me disa lloje persekutimesh që prekin veçanërisht ato. Paragrafi 313 i Raportit Shpjegues përcakton në mënyrë të qartë se Shtetet “mund, nëse dëshirojnë” të zgjerojnë interpretimin te individët që janë homoseksual, biseksual ose transgjinor, të cilët gjithashtu mund të përballen me forma të veçanta të persekutimit dhe dhunës gjinore. Sidoqoftë, “(...) nuk është qëllimi i këtij paragrafi [paragrafi 311] të rrëzojë dispozitat e Konventës së vitit 1951 [Konventa e Gjenevës në lidhje me statusin e refugjatëve], veçanërisht në lidhje me kushtet e dhënies së statusit të refugjatit të imponuar nga neni 1 i asaj Konvente”. Konventa e Stambollit nuk e ndryshon Konventën e Gjenevës të vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve.

94. Prandaj, detyrimet sipas Konventës së Stambollit nuk shkojnë më larg se ato që rrjedhin nga KEDNJ dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ. Frika se ratifikimi i Konventës së Stambollit do të krijonte angazhime të reja në fushën e ligjit për azilin nuk duket e justifikuar.

95. Prandaj, trajtimi nga një këndvështrim gjinor i ndjeshëm i dhunës ndaj grave dhe vajzave migrante dhe azil-kërkuese duket se është në përputhje me Kushtetutën e Armenisë (krijimi i dy nën-kategorive të njerëzve veçanërisht të cënueshëm ndaj dhunës në familje dhe

<sup>114</sup> GJEDNJ, N. kundër Suedisë, Aplikimi Nr. 23505/09, 20 Korrik 2010. Shih, gjithashtu, midis shumë precedentëve të tjerë të rëndësishëm GJEDNJ, RH kundër Suedisë, Aplikimi Nr. 4601/14, 10 Shtator 2015, paragrafi 70 për sa i përket situatë së grave në Somali.

asaj me bazë gjinore, duke pasur nevojë për mbrojtje nga Shteti, gjë që frymëzohet nga mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut, veçanërisht e drejta e jetës, e drejta për shëndet dhe e drejta për dinjitet njerëzor dhe përputhet me nenin 30 dhe nenin 86(4) të Kushtetutës së Armenisë).

## VI. Konkluzione

96. Komisioni i Venecias rithekson se ratifikimi i një traktati është një akt sovran i Shtetit, që do të thotë se shteti është plotësisht i lirë në zgjedhjen e tij, nëse do të ratifikojë apo jo një traktat dhe si rezultat, të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin. Gjithashtu, është një veprim sovran i shtetit zgjedhja e llojit të marrëdhënies që do të dëshironte të krijonte ndërmjet rendit të tij të brendshëm dhe atij ndërkombëtar d.m.th. çfarë statusi do të ketë një traktat brenda rendit juridik të brendshëm, pasi të ratifikohet.

97. Sipas Kushtetutës së Armenisë, vlerësimi i pajtueshmërisë së një traktati, (p.sh. Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje - Konventa e Stambollit) me Kushtetutën është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të Armenisë, me kërkesë të Qeverisë së Armenisë, përpara se të ratifikohet traktati. Prandaj, pikëpamjet e shprehura nga Komisioni i Venecias mund t'i shërbejnë kësaj Gjykate në detyrën e saj, duke siguruar një analizë juridike të jashtme të Konventës së Stambollit. Ato gjithashtu mund të kontribuojnë në debatin publik mbi ratifikimin e kësaj Konvente.

98. Përfundimet e arritura mbi çështjet kryesore të ngritura në kontekstin e këtij mendimi janë si më poshtë:

### A. Në lidhje me pretendimet se Konventa e Stambollit nuk është e nevojshme:

99. Ekzistojnë tre pohime për t'u marrë në konsideratë. Pohimi i parë është i një natyre faktike. Meqenëse dhuna në familje është një fenomen i përhapur dhe i gjerë në Evropë dhe prek të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, përfshirë edhe Armeninë, nga ratifikimi i kësaj Konvente do të përfitonin shumë nga viktimat e fenomeneve të tilla.

100. Pohimi i dytë ka të bëjë me mungesën e pretenduar të elementeve të reja të paraqitura nga Konventa e Stambollit, me objekt që tashmë është adresuar në mënyrë adekuate në instrumentet e tjera juridike ndërkombëtare. Ekzistojnë disa instrumente të ndryshme për të drejtat e njeriut, si në nivelin universal ashtu edhe në atë rajonal, të cilat janë ratifikuar nga Armenia dhe që merren me disa nga çështjet e përfshira në Konventën e Stambollit. Sidoqoftë, Konventa e Stambollit mbështetet në këto instrumente dhe është përqendruar posaçërisht në dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, të cilat nuk adresohen në mënyrë të qartë nga instrumentet më të vjetra, duke futur dispozita të reja dhe duke adoptuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj fenomenit që njëkohësisht siguron një mekanizëm specifik monitorimi. Pra, Konventa e Stambollit paraqet një vlerë specifike të shtuar në krahasim me traktatet ndërkombëtare të ratifikuara më parë në këtë fushë.

101. Pohimi i tretë thekson se Konventa e Stambollit nuk është e nevojshme sepse tashmë ekziston një kornizë e kënaqshme legjislative kombëtare për të luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave. Ndërsa i takon secilit shtet të vlerësojë në dritën e të dhënave faktike, se cilat janë mjetet më të mira për të trajtuar fenomenet e përfshira nga Konventa e Stambollit në nivelin kombëtar, prania e një infrastrukture të brendshme, e shëndoshë për të mbrojtur të drejtat e njeriut, nuk e zvogëlon nevojën dhe vlerën e shqyrtimit të jashtëm. Këta elementë janë plotësues dhe jo kontradiktorë. Mbikëqyrja e jashtme nga instrumentet ndërkombëtare sjell me vete këto aspekte pozitive: (a) ratifikimi i një instrumenti ndërkombëtar ka një domethënie simbolike (autoritetet shtetërore dërgojnë një sinjal të fortë se janë seriozë në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve / luftimin e një fenomeni të veçantë), (b) niveli ndërkombëtar siguron një forum për të diskutuar mangësitë e

pretenduara në nivelin rajonal, shkëmbimin e praktikave të mira dhe qasjeve të autoriteteve kombëtare për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, dhe (c) instrumenti ndërkombëtar mund të sigurojë mbrojtje shtesë në krahasim me kornizën kombëtare.

*B. Në lidhje me pretendimin se Konventa e Stambollit përmban terma dhe koncepte të caktuara që bien ndesh me termat dhe konceptet e përcaktuara në kushtetutën kombëtare të vendit në shqyrtim*

102. Ky pohim ka të bëjë kryesisht me termat *gjini, identitet gjinor, familje, martesë* dhe *orientim seksual*.

103. *Gjinia*: Kushtetuta e Armenisë nuk i referohet gjinisë, por garanton barazinë e burrave dhe grave (neni 30) dhe parashikon “promovimin e barazisë faktike midis grave dhe burrave” (neni 86(4)) si një nga objektivat të politikës së shtetit. Eliminimi i dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe promovimin e masave që synojnë arritjen e tij, si dhe masave që kërkojnë të ndryshojnë stereotipat e dëmshme gjinore, është plotësisht në përputhje me këtë rregullore kushtetuese.

104. *Identiteti gjinor*: Konventa e Stambollit nuk kërkon që Shtetet Palë të ndërmarrin masa për të njohur këto kategori të ndryshme personash ose t'u japin atyre ndonjë status të veçantë juridik, por thjesht konfirmon se identiteti gjinor renditet midis bazave të ndaluara të diskriminimit. Kjo rregullore duket se është plotësisht në përputhje me nenin 28 (barazinë e përgjithshme para ligjit) dhe nenin 29 (ndalimin e diskriminimit) të Kushtetutës së Armenisë.

105. *Familja*: Ndonjëherë pretendohet se Konventa e Stambollit jep përkufizime të marrëdhënieve midis partnerëve, të cilat mund të jenë të papajtueshme me përcaktimet e përfshira në kushtetutat e caktuara kombëtare, veçanërisht me përkufizimin e familjes. Megjithatë, Konventa e Stambollit nuk përmban ndonjë përkufizim të familjes, as të marrëdhënieve në përgjithësi apo midis partnerëve të të njëjtit seks, dhe as nuk promovon ndonjë formë të veçantë të marrëdhënieve të tilla. Kështu, Konventa e Stambollit nuk bie ndesh me përcaktimin e kushtetutës kombëtare për familjen.

106. *Martesa*: Konventa e Stambollit përmend vetëm martesën në kontekstin e martesës së detyruar (neni 37) dhe për këtë arsye, nuk bie në kundërshtim me kushtetutat kombëtare që përcaktojnë martesën si bashkim midis një gruaje dhe një burri - që është edhe rasti i Armenisë.

107. *Orientimi seksual*: Ky term i referohet individëve, të cilët janë anëtarë të një pakice seksuale, siç janë homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët (LGBT) si dhe individët që e konsiderojnë veten heteroseksual. Konventa e Stambollit i referohet orientimit seksual vetëm në klauzolën e mosdiskriminimit (neni 4(3)). Ajo nuk kundërshton ekzistencën sipas ligjit të brendshëm të statusit juridik ose pretendimeve të kësaj kategorie, por kjo nuk do të thotë se Konventa imponon një detyrim pozitiv për shtetet, të cilat nuk e pranojnë ekzistencën e këtij statusi, që në mënyrë aktive të prezantojnë një nocion të tillë në rendin e tyre të brendshëm.

*C. Në lidhje me pretendimin se Konventa e Stambollit do të rezultonte në ndryshime legislative që do të kundërshtonin kushtetutën kombëtare të vendit në shqyrtim*

108. *Ndryshimet kryesore të parashikuara në këtë kontekst kanë të bëjnë me martesën midis personave të të njëjtit seks, arsimin dhe raportimin nga profesionistët*.

109. *Martesa midis personave të të njëjtit seks*: Konventa e Stambollit nuk u referohet fare homoseksualëve dhe as nuk i referohet martesës, përveç se në lidhje me martesën e detyruar (neni 37). Prandaj, nuk ka asnjë detyrim për Shtetet Palë në Konventën e



Stambollit të legalizojnë martesën midis personave të të njëjtit seks. Në këtë mënyrë, nuk ka asnjë kundërshtim me Kushtetutën e Armenisë.

110. *Arsimi:* Konventa e Stambollit nuk ndërhyt në të drejtën e prindërve për të arsimuar fëmijët sipas preferencave të tyre. Në të vërtetë, kjo çështje mbetet jashtë fushëveprimit të Konventës, e cila thjesht inkurajon shtetet që të përfshijnë materiale mësimore mbi çështjet e përmendura në dispozitat e saj. Në këtë drejtim, Konventa e Stambollit u jep Shteteve Palë një diskrecion të madh për të vendosur se si (deri në çfarë mase dhe në çfarë mënyre) ata do të edukojnë popullatën e tyre për çështjet e përfshira në të. Prandaj, duket se nuk ka kundërshtim midis nenit 14 të Konventës së Stambollit dhe Kushtetutës së Armenisë.

111. *Raportimi nga profesionistët:* Konventa e Stambollit nuk kërkon heqjen e konfidencialitetit profesional, por nxit shtetet të lehtësojnë raportimin e rasteve të dyshuara të akteve të rënda të dhunës ndaj grave ose dhunës në familje nga profesionistë të caktuar, kryesisht në sektorin e shëndetësisë, pa rrezikuar të sanksionohen për shkelje konfidencialiteti. Konventa e Stambollit i jep Shteteve Palë diskrecionin për të vendosur se cilat masa duhet të marrin dhe nën cilat “kushte të përshtatshme”, me qëllim bërjen të mundur të raportimit nga profesionistët dhe gjithashtu nuk parashikon raportim të detyrueshëm. Pra, Konventa nuk kërkon që shtetet të miratojnë ligjin në atë mënyrë që mund të shihet si i papajtueshëm me dispozitat kushtetuese mbi konfidencialitetin e komunikimit.

*D. Në lidhje me pretendimet se Konventa e Stambollit parashikon një organ me kompetenca të tepërta*

112. Konventa e Stambollit krijon një organ të ri ndërkombëtar, Grupin e ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO) për të monitoruar gjendjen e zbatimit.

113. GREVIO nuk zotëron ndonjë kompetencë të pazakontë për një organ ndërkombëtar dhe kompetencat e tij janë mjaft të kufizuara. Për shembull, ai nuk ka të drejtë të pranojë kërkesa nga individët apo nga shtetet. Ai nuk mund të nxjerrë përfundime detyruese dhe rekomandimet në raportet e tij duhet të nxirren nga Komiteti i Palëve dhe jo nga vetë GREVIO. Kështu nuk ekziston as *de facto* dhe as *de jure* dorëzimi i sovranitetit kombëtar tek një organ i jashtëm i përfshirë në ratifikimin e Konventës së Stambollit.

*E. Në lidhje me pretendimin se Konventa e Stambollit prezanton angazhime të reja në fushën e ligjit për azilin*

114. Në lidhje me ligjin për azilin, ratifikimi i Konventës së Stambollit nuk nënkupton që e gjithë dhuna me bazë gjinore konsiderohet automatikisht si "dëm serioz" ose përdorimi i një qasje të ndjeshme gjinore nuk do të thotë se të gjitha gratë automatikisht do të kenë të drejtë mbi statusin e refugjatit. Ajo thjesht pranon se gratë mund të përballen me disa lloje persekutimesh që prekin veçanërisht ato.

115. Futja e një përkufizimi gjinor të ndjeshëm të dhunës ndaj grave dhe vajzave emigrante dhe azilkërkuese, duket se është në përputhje me Kushtetutën e Armenisë. Krijimi i dy nën-kategorive të njerëzve veçanërisht të cënueshëm nga dhuna me bazë gjinore dhe familjare, të cilët kanë nevojë për mbrojtje nga Shteti, frymëzuar nga mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut, veçanërisht e drejta e jetës, e drejta e shëndetit dhe e drejta e dinjitetit njerëzor është në përputhje me nenin 30 dhe nenin 86(4) të Kushtetutës së Armenisë.

116. Si përfundim, ndërsa i takon Gjykatës Kushtetuese të Armenisë të vendosë mbi pajtueshmërinë e Konventës së Stambollit me Kushtetutën e Armenisë, Komisioni i

Venecias është i mendimit se nuk ka dispozita në Konventë që mund të thuhet se “kundërshtojnë” Kushtetutën e Armenisë. Përkundrazi, detyrimi kryesor i Konventës së Stambollit, përkatësisht të parandalojë dhe luftojë çdo formë të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, tashmë rrjedh nga Kushtetuta dhe nga traktatet e tjera për të drejtat e njeriut, në të cilat Armenia është Shtet Palë.

**Përktheu: Krisi Anastas**